



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TAKSAVE, MJEDISIT DHE TURIZIMIT

Nr. ____ Prot.

Patos, më ____/____/2025

MIRATOHET
KRYETARI
Fation Duro

PROJEKT-VENDIM

Nr. ____ , datë ____/____/2025

**“MBI STRUKTURËN DHE NIVELIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE
VENDORE PËR VITIN 2026”**

KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Mbështetur në gërmën “f”, të nenit 54, të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”;

Ligjin nr. 9632, datë 31.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar;

Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;

Udhëzimin nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligjin nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”;

Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;

Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 132, datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, baza e taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe regullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”, i ndryshuar;

Ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar;

Ligjin nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”;

Ligjin nr. 10081 datë 23.02.2009 “Për Licensat Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”;

Ligjin nr. 10304 datë 15.07.2010 “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”;

Ligjin nr. 8450 datë 24.02.1999 “Për Përpunimin Transportin dhe Tregtimin e Naftës, të Gazit dhe Nënprodukteve të tyre”;

Ligjin nr. 152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”;

Ligjin nr. 93/2015 “Për Turizmin”;

Ligjin nr. 8098 datë 23.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit”;

Ligjin nr. 9506 datë 22.06.2000 “Statusi i Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik”;

Ligjin nr. 8153 datë 31.10.1996 “Për statusin e Jetimit”;

Ligjin nr. 9385 datë 04.05.2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, i ndryshuar;
Ligjin nr. 10465, datë 29.09.2011 “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”;
Ligjin nr. 10279 datë 20.05.2010 “Për Kundravajtjet Administrative”;
Ligjin nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”;
Ligjin nr. 10296 “Për Manaxhimin Financiar dhe Kontrollin”;
Ligjin nr. 10463 datë 22.09.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”;
Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 319 datë 31.05.2018 “Për Miratimin e Masave për Kostot e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve”;

Ligjin nr. 122/2020 për disa ndryshime në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar.

KRYETARI I BASHKISË PATOS:

PROPOZON:

Të miratohet struktura dhe niveli i taksave dhe tarifave vendore, baza e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështet e pagimit, koha e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve.

I. Llojet e Taksave vendore

1. Taksa mbi Pasurinë e Paluajtshme në të cilën përfshihen
 - Taksa mbi ndërtesat
 - Taksa mbi tokën bujqësore
 - Taksa mbi truallin
2. Tatimi thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël.
3. Taksa e fjetjes në Hotel
4. Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga ndërtimet e reja
5. Taksa e Tabelës
6. Taksa të përkohshme

II. Llojet e Taksave të ndara

1. Të ardhura nga rregjistrimi i mjeteve të përdorura.
2. Të ardhura nga renta minerare.
3. Të ardhura nga TAP.
4. Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme

III. Llojet e tarifave

1. Tarifa e Pastrimit për Familjet
2. Tarifa për Shërbimin Komunitar
3. Tarifa e Pastrimit për Biznesin
4. Tarifa e Gjelbërimit për Biznesin
5. Tarifa e Ndriçimit për Biznesin

6. Tarifa për mjetet e transportit
7. Tarifa për dhënie Leje ushtrim aktiviteti
8. Tarifa për Shërbime Administrative dhe urbanistike
9. Tarifa e Zënies së Hapësirës Publike
10. Tarifa e Ndotjes Mjedisore/Përmirësim Mjeditari
11. Tarifa të ndryshme në funksion të Drejtorive dhe Ndërmarrjeve vartëse.
12. Tarifa për dhënie/marrje me qira të pronave të Bashkisë Patos

KAPITULLI I : Taksat vendore

1. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme.

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të mësipërme, në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive. Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe. Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente pronësie.

Në taksat mbi pasurinë e paluajtshme përfshihen:

- a) taksa mbi ndërtesat
- b) taksa mbi tokën bujqësore
- c) taksa mbi truallin

Rregulla të përbashkëta të taksës mbi pasurinë e paluajtshme.

1. Taksat llogariten si detyrim vjetor i taksapaguesit. Nëse pasuria e taksueshme krijohet, tjetërsohet ose zhduket brenda kësaj periudhe, detyrimi i taksapaguesit llogaritet proporcionalisht vetëm për periudhën e të drejtës së pronësisë.
2. Metodologjinë për përcaktimin e vlerës së tatueshme të pasurisë së paluajtshme – ndërtesa, miratohet nga Këshilli i Ministrave.
3. Kategoritë minimale të bazës së taksës sipas klasifikimit dhe nivelet respektive të taksës mbi tokën bujqësore dhe mbi truallin (jo hapësirë publike), jepen përkatësisht, në anekset e ligjit, dhe janë pjesë përbërëse e tij.
4. Këshilli bashkiak vendos për nivelin e taksës, që do të zbatohet për çdo kategori minimale të bazës së taksës, të parashikuar në ligj, në kufijtë plus-minus 30 për qind të nivelit tregues të taksës për kategorinë përkatëse.
5. Kur për një kategori minimale të bazës së taksës, këshilli bashkiak miraton nënkategori, ai, detyrimisht, përcakton edhe nivelin e taksës për secilën nënkategori. Niveli i taksës për çdo nënkategori është brenda kufijve të përcaktuar në pikën 3 të nenit 21 të ligjit nr. 9632, datë 31.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar. Këshilli bashkiak vendos për lehtësimin ose përjashtimin nga detyrimi për pagimin e taksave për:
 - a) personat, të cilët kanë të ardhura nën minimumin jetik, sipas kritereve të përcaktuara në nivel kombëtar;

b) taksapaguesin, pasuria e të cilit është dëmtuar nga veprimi i forcave madhore. Në këtë rast, lehtësimi ose përjashtimi është i përkohshëm dhe kohëzgjatja përcaktohet nga këshilli bashkiak, në raport me dëmin e shkaktuar deri në vlerën 75 për qind.

Vërtetimi i pronësisë për efekt të detyrimit për pagimin e taksave.

Për efekt të detyrimit për pagimin e taksave të taksapaguesit, zyrat e taksave të bashkisë njohin dokumentet e vërtetimit të pronësisë, sipas regjistrimit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme njoftojnë rregullisht, çdo 3 muaj, bashkitë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Taksës së Pasurisë për regjistrimet e reja të kryera dhe ndryshimet e gjendjes së pronave. Nëse prona nuk është e regjistruar në regjistrin e pasurisë së paluajtshme, për efekt të detyrimit për pagimin e taksës nga taksapaguesit, zyrat e taksave të bashkisë, për vërtetim pronësie njohin vërtetimin e pronësisë, vendimet e komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronës, vendimet e privatizimit ose dokumentet e tjera, të lëshuara nga organet përkatëse shtetërore, në përputhje me legjislacionin përkatës.

Në rastin e mungesës së dokumentacionit të vërtetimit të pronësisë, bashkia vendos madhësinë e sipërfaqes së tatueshme, bazuar në vendimin e komisionit të verifikimit të pasurisë së paluajtshme. Organet e pushtetit vendor ngrenë komisionin e verifikimit të pasurive të paluajtshme, në rast mungese të dokumentacionit ligjor. Detyrat dhe funksionet e këtij komisioni përcaktohen me vendim të këshillit të bashkisë.

Zyrat e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme nuk bëjnë regjistrimin apo çregjistrimin e pasurisë së paluajtshme, ndërtesë apo tokë bujqësore, nëse dokumentacioni i vërtetimit të pronësisë nuk shoqërohet edhe me vërtetimin e bashkisë, i cili konfirmon pagesën e taksave respektive që nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Pronat që shtrihen në territorin e më shumë se një njësie të qeverisjes vendore.

Në rast se një pronë shtrihet në territorin e më shumë se një bashkie, pavarësisht nga vendbanimit i pronarit, secila njësi vendore e trajton pjesën e pronës, që ndodhet brenda territorit të vet, si pronë më vete dhe zbaton mbi të dispozitat e këtij ligji.

1 a) Taksa mbi ndërtesat

- ❖ Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen individët, personat fizikë ose juridikë, vendës apo të huaj, pronarë ose përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave, përveç rasteve kur në këtë ligj përcaktohen ndryshe.
- ❖ Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, sipas ligjit “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.
- ❖ Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse, të lëshuar nga autoriteti i planifikimit. Afati i

përlllogaritjes së taksës fillon nga momenti i mbarimit të afatit kohor të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

- ❖ Detyrimi për taksën mbi ndërtesat llogaritet si shumëzim i bazës së taksës me shkallën e taksës mbi ndërtesën.
- ❖ Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme-ndërtesë llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Pagesa e taksës bëhet çdo muaj apo për periudha më të gjata, në varësi të kategorisë së taksapaguesit, sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave.
- ❖ Shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës, është si më poshtë:

a) 0,05% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim;

b) 0,2% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;

c) 30% e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

- ❖ Baza e taksës mbi ndërtesat është vlera e ndërtesës, që llogaritet në përputhje me metodologjinë dhe procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

→ Çmimi mesatar referues i shitblerjes së ndërtesave që përdoren për qëllim banimi për Bashkinë Patos është 28,000 lekë/m².

→ Këshilli Bashkiak vendos për nivelin e taksës, që do të zbatohet për çdo kategori minimale të bazës së taksës, të parashikuar në ligj, në kufijtë plus-minus 30 për qind të nivelit tregues të taksës për kategorinë përkatëse.

Për vitin fiskal 2026 shkalla e taksës për bizneset që kanë aktivitet brënda Bashkisë Patos propozojmë të rritet me 30% mbi përcaktimin ligjor, dhe nga 0.2 % do të jetë 0.26 % ndërsa për Njësitë Administrative propozojmë të rritet me 10 % dhe nga 0.2 % do të jetë 0,22 %.

Ndërsa shkalla e taksës së ndërtesës për familjarët për Bashkinë Patos propozojmë të rritet me 10 %, mbi përcaktimin ligjor dhe nga 0.05 % do të bëhet 0.055 %, për Njësitë Administrative: Zharrëz me shtrirje në zonat kadastrale (1142,1638,3361,3743,3922) dhe Njësinë Administrative Rozhdie me shtrirje në zonat kadastrale (3250,1773,3457,1537,2111) propozojmë të mbeten në nivelin e ligjit, 0.05 %.

Tabela 1 Koeficientët e qëllimit të përdorimit të pronës.

Qëllimi i Përdorimit të Pronës	Koeficienti
Për banesa për qëllim banimi	100%
Për ndërtesa të privatizuara me ligjin nr.7652 datë 23.12.1992	70%
Njësi Tregtimi dhe Shërbimi	150%
Për Parkim të mbuluar	70%
Për Parkim të hapur	30%
Për veprimtari Industriale	50%
Për veprimtari bujqesore & blegtorale	30%

Taksa mbi pasurinë e paluajtshme llogaritet si me poshtë:

[Çmimi Vlerësues] x [Koeficient e qëllimit të përdorimit të pronës] x [Shkalla e taksës]

Tabela 2 Mënyra e llogaritjes së taksës për m² sipas kategorive

Nr.	Kategoritë dhe nënkategoritë	Njësia	Niveli i taksës mbi ndërtesat	
			Bashkia Patos	Njësitë Administrative
	Për ndërtesat e privatizuara me ligjin nr.7652 datë 23.12.1992	Lekë/ m ² / sip shfrytëzimi	28,000x70 % x 0.055 x m ² = 10.78 lekë/m ²	28,000 x70%x 0.05 x m ² = 9.80 lekë/m ²
1	Ndërtesa që përdoren dhe shfrytëzohen për qëllime banimi.	Lekë/ m ² / sip shfrytëzimi	28,000 x 0.055 x m ² = 15.40 lekë/m ²	28,000 x 0.05 x m ² = 14 lekë/m ²
2	Ndërtesa që përdoren dhe shfrytëzohen për veprimtari ekonomike, (tregti ose edhe procese të perziera prodhimi, tregëtim dhe ose/ edhe shërbime me pakicë)	Lekë/ m ² / sip shfrytëzimi	28,000 x 1.5 x m ² x 0,26%=109.2 lekë/m ²	28,000 x 1.5 x m ² x 0,22% = 92.4 lekë/ m ²
3	Veprimtari industriale, si prodhimi, përpunimi, magazinimi i lëndve të para, të gjysëmprodutëve apo produtëve të gatshme industriale si: fabrika, magazina, depo, silos, magazina frigoriferike të produtëve ushqimorë, si dhe objekte të tjera të ngjashme me to.	Lekë/ m ² / sip shfrytëzimi	28000 x 0.26% x m ² x 50%=36.4 lekë/ m ²	28000 x 0.22% x m ² x 50%=30.80 lekë/ m ²
3.1	Ndërtesat për veprimtari arsimorë jo publike të çdo niveli si dhe ambientet sportive të mbyllura përfshi dhe pishinat e mbyllura.	Lekë/ m ² / sip shfrytëzimi	28000 x 0.26% x m ² x 50%=36.4 lekë/ m ²	28000 x 0.22% x m ² x 50%=30.80 lekë/ m ²
4	Parkim i mbuluar dhe bodrume ndërtim konstruksioni druri dhe metalik.	Lekë/ m ² / sip shfrytëzimi	28,000 x 0.26% x m ² x 70%=50.96 lekë/ m ²	28,000 x 0.22% x m ² x 70%= 43.12 lekë/ m ²
5	Parkim i hapur, pishinë e hapur, ambiente sportive të hapura,	Lekë/ m ² / sip shfrytëzimi	28,000 x 0.26% x m ² x 30%=21.84 lekë/ m ²	28,000 x 0.22% x m ² x 30%=18.48 lekë/ m ²

	porte dhe aeroporte te çdo kategorie.			
6	Veprimtari në fushën e bujqësisë dhe blektorisë si dhe veprimtari mbështetëse si grumbullim, magazinim dhe ruajtje produkte bujqësore e blektorale me përjashtim të përpunimit ushqimor.	Lekë/ m ² / sip shfrytëzimi	28,000 x 0.26% x m ² x 30% = 21.84 lekë/m ²	28,000 x 0.22% x m ² x 30% = 18.48 lekë/ m ²
7	Për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.	Lekë/ m ² / sip shfrytëzimi	28,000 x 0.26% x m ² x 30% = 21.84 lekë/m ²	28,000 x 0.22% x m ² x 30% = 18.48 lekë/ m ²

Baza e taksës mbi ndërtesat është vlera e ndërtesës, që llogaritet në përputhje me metodologjinë dhe procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Dokumentat që vërtetojnë pronësinë janë: Çertifikata e Pronësisë, Vërtetim hipotekor, Leje legalizimi, vendimet e komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronës, vendimet e privatizimit ose dokumentet e tjera, të lëshuara nga organet përkatëse shtetërore, në përputhje me legjislacionin përkatës.

Në kategorinë “**Ndërtesa Banimi**”, përfshihen: - Të gjitha ndërtesat që ju shërbejnë njerzve për nevoja thmeloze banimi, duke përfshirë shtëpitë, apartamentet banesat dhe ndërtesat e ngjashme; garazhet e mbyllura bodurumet çdo ndërtesë tjetër e ngjashme, mbi apo nënë tokë, që nuk përdoret apo nuk shfrytëzohet për qëllime të tjera veç atij të banimit. - Ndërtesa në pronësi të shoqërive të ndërtimit të pashitura, por të hipotekuara si ndërtesa banimi.

Sipërfaqja e Prezumuar, për ndërtesat që përdoren, shfrytëzohet për banim, nese identifikohet ekzistenca, por nuk arrihet të përcaktohet sipërfaqja e ndërtesës/njesisë pronësore, përdoren vlerat referuese për sipërfaqe, si më poshtë vijnë:

- 100 (njëqind) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim;
- 70 (shtatëdhjetë) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim, të privatizuar me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", të ndryshuar.

Në kategorinë “**Ndërtesa për veprimtari ekonomike**”, përfshihen: Çdo veprimtari e kryer nga prodhuesit, tregtarët, personat që furnizojnë mallra dhe shërbime, përfshirë veprimtaritë nxjerrëse, industriale, tregtare, të shërbimit bujqësorë dhe veprimtari profesionale. Veprimtari ekonomike konsiderohet, gjithashtu shfrytëzimi i pasurisë së trupëzuar ose të patrupëzuar, me qëllim realizimin e të ardhurave me karkater të vazhdueshëm. Ndarje e njesisë pronësore për veprimtari ekonomike, pjesa e njesisë pronësore që përdoret për veprimtari ekonomike.

Në kategorinë **”Ndërtesa për veprimtari prodhuese”** - “Ndërtesa për veprimtari prodhim” do të kuptojmë të gjitha ndërtesat në të cilat ushtrohet aktivitet prodhues si përpunim duralumini, metalesh, druri, tapecierie, letre, kartoni, plasmasi, tulla, tjegulla, blloqe banimi, furra gëlqereje, prodhime ushqimore, furrë buke, prodhim konfeksionesh, prodhim dhe përpunim vajrash, naftë etj., shtypshkronja, prodhim dhe përpunim produktesh farmaceutike dhe të ngjashme me to.

Për ato kategori ndërtesash banimi të cilat janë të regjistruara si **Seli të subjekteve tregtare**, taksa e pasurisë përlllogaritet dhe paguhet si “Ndërtesa për veprimtari ekonomike”, sipas rastit të ushtrimit të veprimtarisë duke u përjashtuar nga Kategoria “Ndërtesa banimi”.

Për ndërtesat në pronësi të shoqërive të ndërtimit, të destinuara për shitje, por që janë ende të pa shitura, taksa do të vendoset sipas destinacionit të përdorimit të ambientit të ndërtesës. Ambiente të hipotekuara si:

- ❖ **Apartamente banimi** do ti nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategorinë “ndërtesa që përdoret, shfrytëzohet për banim”.
- ❖ **Njësi biznesi** do ti nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategorinë “ndërtesa që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike”.
- ❖ **Bodrum/parking i mbuluar** do ti nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategorinë “ndërtesa që përdoret për parkim të mbuluar dhe bodrume”.

Përjashtime

Përjashtohen nga taksa mbi ndërtesat:

- ❖ Pronat e shtetit dhe të Njërive të Qeverisjes Vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
- ❖ Pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
- ❖ Ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
- ❖ Banesat sociale në pronësi të Bashkive;
- ❖ Pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me Bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
- ❖ Ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
- ❖ Strukturat akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “*brand name*”;
- ❖ Ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që përfitojnë pension pleqërie ose pension social, që janë me banim në fshat ose qytet, kur familja përbëhet vetëm nga pensionistët ose dhe me persona në ngarkim të tyre që janë të paaftë për punë, me kushtin që dokumenti pronësis të jetë në emër të kryefamiljarit pensionist.
- ❖ Ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
- ❖ Ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse.

Afatet e pagesës

1. Detyrimi vjetor për kategorinë “ndërtesa” që përdoret, shfrytëzohet për banim do të paguhet brenda datës 30.12.2026.
2. Detyrimi vjetor për kategorinë “ndërtesa” që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike do të paguhet brenda datës 30.06.2026.

Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar, të paguajë shumën e detyrimit tatimor, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer.

Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.

Përfshihen nga pagesa e gjobës për vonesë në pagesë të gjithë taksapaguesit familjarë.

Struktura përgjegjëse për arkëtimin e kësaj takse:

-Për ndërtesa banimi për Njësinë Administrative Patos është punonjësi i sportelit të ardhurave vendore.

-Për ndërtesa banimi për Njësinë Administrative Zharrëz, Ruzhdië janë vetë Njësitë Administrative.

-Për biznesin është Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Taksave, Mjedisit dhe Turizmit.

1b) Taksa mbi Tokën Bujqësore

- ❖ Taksa mbi token bujqësore llogariten si detyrim vjetor i taksapaguesit. Nëse pasuria e taksueshme krijohet, tjetërsohet ose zhduket brenda kësaj periudhe, detyrimi i taksapaguesit llogaritet proporcionalisht vetëm për periudhën e të drejtës së pronësisë.
- ❖ Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi në përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së tokës bujqësore, pranë bashkisë ku ndodhet toka. Kategoritë minimale të tokave bujqësore jepen në aneksin 1, të ligjit 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Për çdo kategori minimale të tokës bujqësore, këshilli bashkiak mund të miratojë nënkategorizime.
- ❖ Niveli i taksës caktohet në lekë për hektar. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme. Nivelet treguese të taksës, për çdo kategori minimale të bazës së taksës, jepen si më poshtë:

Tabela 3 Niveli i taksës mbi tokën bujqësore

Nr.	Klasifikimi sipas kategorisë së tokës bujqësore	Vlera sipas Ligjit lekë/hektar/vit
1	I	5600 lekë/ha/vit
2	II	4900 lekë/ha/vit

3	III	4200 lekë/ha/vit
4	IV	3600 lekë/ha/vit
5	V	3000 lekë/ha/vit
6	VI	2400 lekë/ha/vit
7	VII deri X	1800 lekë/ha/vit

Afati i pagesës

Detyrimi për taksën mbi tokën bujqësore është vjetor. Për të gjitha kategoritë ky detyrim paguhet me një këst. Afati i pagesës është data 30 Dhjetor 2026.

Përfshihen nga pagesa e gjobës për vonesë në pagesë të gjithë taksapaguesit familjarë.

Lehtësira dhe përjashtime:

1. Tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutorë dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.
2. Taksapaguesi, pasuria e të cilit është dëmtuar nga veprimi i forcave madhore. Në këtë rast, lehtësimi ose përjashtimi është i përkohshëm dhe kohëzgjatja përcaktohet nga këshilli bashkiak në raport me dëmin e shkaktuar deri në vlerën 75 për qind.
3. Personat, të cilët kanë të ardhura nën minimumin jetik, sipas kriterëve të përcaktuara në nivel kombëtar;
4. Për taksapaguesit të cilët do të paguajnë taksën e tokës bujqësore brenda muajt Gusht do të ulët taksa në masën 20 përqind për Njësinë Administrative Patos, Njësinë Administrative Zharrëz dhe Njësinë Administrative Rozhdie.
5. Përfshihen nga taksa e tokës bujqësore, vetëm për normën individuale të tokës, individët:

- Invalidët e punës e të luftës, veteranët.
- Të verbërit, të sëmurët, paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Për të përfutur nga përjashtimi, këto familje apo individ duhet të dorëzojnë në zyrën e taksave pranë Bashkisë ose të Njësisë Administrative dokumentat e mëposhtëm.

- Librezën përkatëse;
- Proçesverbalin e mbajtur nga komisioni i verifikimit për mbjelljet e reja.
- Vendimin e Këshillit Bashkiak.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës mbi tokën bujqësore janë:

- Për tokën bujqësore, në Njësitë Administrative Zharrëz, Ruzhdie, janë vetë Njësitë Administrative.
- Për tokën bujqësore, për Njësinë Administrative Patos është punonjësi i sportelit të ardhurave vendore.

Ngarkohet Drejtoria e Bujqësisë në bashki për përcaktimin e sipërfaqes në pronësi, sipas personave, sipas Njësisë Administrative, duke pasqyruar dhe ndryshimet e bëra.

Klasifikimi sipas kategorive të tokës bujqësore bëhet nga Sektori i Menaxhimit të Tokës Bujqësore.

1c) Taksa mbi Truallin

- ❖ Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim, pranë Bashkisë apo Njësisë Administrative, ku ndodhet trualli.
- ❖ Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme. Për nivelet treguese të taksës, për çdo qellim përdorimi, propozojmë: Vlera e taksës së truallit për qëllime banimi të ngelen në nivlet e përcaktuar nga ligji, ndersa vlera e taksës së truallit për qëllime biznesi të rritet me 25% mbi përcaktimin ligjor. Nivelet treguese të taksës, për sejcilin qellim përdorimi, jepen si më poshtë:

Tabela 4 Niveli i taksës mbi truallin

Bashkia Patos	Vlera e taksës për qëllime banimi për individë	Vlera e taksës për qëllime biznesi
	0.14 lekë/m ² /vit	15 lekë/ m ² /vit

Afatet e pagesës

- 1.Detyrimi vjetor për kategorinë “truall” që përdoret, shfrytëzohet për qëllime banimi do të paguhet brenda datës 30.12.2026.
- 2.Detyrimi vjetor për kategorinë “truall” që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike do të paguhet brenda datës 30.06.2026.

Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar, të paguajë shumën e detyrimit tatimor, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.

Përrjashtohen nga pagesa e gjobës për vonesë në pagesë të gjithë taksapaguesit familjarë.

Struktura përgjegjëse për arkëtimin e kësaj takse:

- Për kategorinë “truall” për banim për Njësinë Administrative Patos është punonjësi i sportelit të ardhurave vendore.
- Për kategorinë “truall” për banim për Njësinë Administrative Zharrëz, Ruzhdie janë vetë Njësitë Administrative.
- Për biznesin është Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Taksave, Mjedisit dhe Turizmit.

2.Taksa e fjetjes në hotel

Me “hotel” kuptohet çdo veprimtari, që jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet hotel, motel, stabiliment turistik, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim. Hotelet ndahen në kategori: Hotele me 4-5 yje

dhe motele, bujtina, fjetore, stabilimente turistike dhe çdo njësi tjetër akomoduese sipas përcaktimit të Ligjit “Për turizmin” .

- ❖ Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel.
- ❖ Niveli tregues i taksës është sipas tabelës së mëposhtme
- ❖ Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga Bashkia, për natë qëndrimi, me numrin e netëve të qëndrimit në hotel.
- ❖ Detyrimi për taksën i takon klientit që strehoet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet hoteli. Në faturën e hotelit shënohet çmimi i fjetjes dhe mbi të vlera e taksës.
- ❖ Në rastet kur subjekti nuk mban regjistër të klientëve dhe nuk deklaron për numrin e fjetjeve në hotel, administratës tatimore i lind e drejta, të bëjë vlerësim mbi bazën e numrit të dhomave që disponon subjekti.

Tabela 5

Kategoritë	Niveli i taksës
Hotel 4-5 yje	105 lekë/për cdo fjetje
Bujtinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese	35 lekë/natë

Afatet e pagesës

Taksa e fjetjes në hotel paguhet brenda datës 5 të muajit pasardhës.

Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar, të paguajë shumën e detyrimit tatimor , detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer.

Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.

Struktura përgjegjëse për arkëtimin e kësaj takse:

Ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Taksave, Mjedist dhe Turizimit për arkëtimin e kësaj takse.

3.Taksa e ndikimit në infrastrukturë

1. Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet sipas preventivit, ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investimi ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

2. Në rastin e ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi apo për njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi, shkalla e taksës së ndikimit në infrastrukturë është në masën 4 (katër) për qind deri 8 (tetë) për qind të çmimit të shitjes për metër katror.

Në këtë kategori investimesh përfshihen edhe ndërtimet zëvendësuese për qëllime banimi, të kushtëzuara për t’u ndërtuar si shkak i zbatimit të një kontrate koncensionare, e cila prek banesat ekzistuese. Gjithashtu, në këtë kategori përfshihen edhe ndërtimet e destinuara për qendra tregtare apo të biznesit.

Baza e taksës është vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së ndërtimeve për qëllime banimi apo të njësive të tregtimit dhe shërbimit. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve të nxjerrë me akt nga Këshilli i Ministrave.

3. Në rastin e ndërtimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit dhe është:
- a) Për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, bujqësisë; të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara vetë individi apo me sipërmarrës; si dhe të ndërtimeve për qëllime publike, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 1 (një) deri në 3 (tre) për qind e vlerës së investimit.
 - b) Për projekte të infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja është 0.1 (zero pikë një) për qind e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit.
 - c) Për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0.5 (zero pikë pesë) për qind e vlerës së investimit.
 - d) Për ndërtesat, që destinohen për qëllime banimi në zonat malore, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 0 (zero) deri në 3 (tre) për qind të vlerës së investimit. Këshilli Bashkiak përcakton me vendim zonat malore për efekt të zbatimit të këtij paragrafi.
4. Këshilli Bashkiak miraton kategori dhe nënkategori për klasifikimin e investimeve, të cilat mund të përdoren për vendosjen e nivelit të taksës.
5. Detyrimi për pagesën e taksës i takon investitorit. E ardhura nga taksa, për çdo rast, mbledhet nga organi që lëshon lejen e ndërtimit dhe arkëtohet, për çdo rast, për llogari të bashkisë, që mbulon territorin ku do të bëhet investimi.
6. Nëse objekti, për të cilin do të bëhet investimi, shtrihet në territorin e më shumë se një bashkie ose kur objekti ndikon në infrastrukturën e një bashkie tjetër, të ardhurat nga taksa ndahen proporcionalisht ndërmjet tyre, në përputhje me raportet përkatëse të shtrirjes së objektit dhe të ndikimit të investimit në infrastrukturën e secilës bashki.
7. Taksa paguhet brenda 5 ditëve nga data e marrjes së vendimit për miratimin e lejes për punime dhe lëshimit të autorizimit të pagesës nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit. Në rast se kërkuesi nuk kryen pagesën brenda 5 ditëve pune nga njoftimi për detyrimin ndaj shtetit, sipas ligjit, atëherë për çdo ditë vonesë i llogaritet kamate 0,2 për qind në ditë e shumës që duhet të paguaje, deri në 30 ditë pune. Nëse në përfundim të këtij afati kërkuesi ende nuk ka paguar detyrimin, Kryetari i Bashkisë vendos masa të tjera të përshtatshme, deri në revokimin e vete lejes së miratuar.
8. Për kategoritë ku niveli i taksës aplikohet mbi vlerën e investimit, në përfundim të punimeve të kryera sipas lejës së miratuar, bëhet kontrolli i pagesave me situacionin përfundimtar të objektit të ndërtuar nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe nëse ka diferenca mes vlerës së investimit sipas situacionit përfundimtar dhe preventivit, njoftohet subjekti për vlerën e diferencë që është i detyruar të shlyejë. Mosshlyerja e këtij detyrimi përbën shkak për pezullimin e procedurave të pajisjes me leje përdorimi të subjektit.
9. Përfshihen nga pagesa e kësaj takse investimet e kryera për ndërtimin e strukturave akomoduese “Hotel/Resort me pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur “brand name”.
10. Përfshihen nga pagesa e kësaj takse edhe investimet e subjekteve, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si “agroturizëm”, sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit.
11. Përfshihen nga pagesa e kësaj takse investimet për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave, të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore, sipas përkufizimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen civile. Kushtet, rregullat dhe dokumentet që shoqërojnë kërkesën për përfshirjen nga detyrimi për pagesën e taksës së

ndikimit në infrastrukturë, sipas kësaj pike, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave (Ndryshuar me Ligj Nr. 142/2015, datë 17.12.2015. (Ndryshuar me Ligj Nr. 106/2017, datë 30.11.2017 (Ndryshuar me Ligj Nr. 41/2018, datë 09.07.2018. (Ndryshuar me ligjin nr. 95/2018, datë 03.12.2018,(Ndryshuar me ligjin nr 122/2020) (Shtuar me Aktin Normativ Nr. 3, datë 2.10.2019, si dhe Vendimi nr. 145 date 13.02.2020.

Tabela 6

Taksa e ndikimit në infrastrukturë

Nr.	Kategorit/Nën kategorit	Taksa e ndikimit në infrastrukturë Zonat			Njësitë Administrative
		Zona A	Zona B	Zona C	Zona D
1.	Objekte Banimi	%	%	%	%
	a) 1 Kat	4	4	4	4
	b) 2 kate - 3 kate	5	5	4	4
	c) 4 kate – 6 kate	6	6	5	4
	d) Mbi 6 kate	8	7	6	6
2.	Objekte në funksione biznesi	4	4	4	4
3.	Ndërtime me objekt prodhimi				
	a) Ndërtime me funksion prodhimi përpunimi të produkteve bujqësore dhe blegtorale	2	2	2	2
	b) Ndërtime me funksion prodhimi Industrial.	3	3	3	2
4.	Objekte për përdorim publik	2	2	2	1
5.	Institucione fetare, bamiresie etj të ngjashme.	2	2	2	1
6.	Leje zhvillimore infrastruktura,ujësjellës, kanalizime, rrugë kombëtare etj.	0.1	0.1	0.1	0.1
7.	Për ndërtimet të cilat janë në proces legalizimi.	0.5	0.5	0.5	0.5

Struktura përgjegjëse për arkëtimin e kësaj takse

E ardhura nga taksa, për çdo rast, mbledhet nga organi që lëshon lejen e ndërtimit dhe arkëtohet, për çdo rast, për llogari të bashkisë, që mbulon territorin ku do të bëhet investimi.

4.1 Garanci financiare për subjektet fizike/juridike, kërkues i lejes për ndërtimin, riparimin, restaurimin apo shembjen e objektit:

Garancia financiare: Në mbështetje të pikës 10 të VKM-se Nr. 575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, subjekti fizik/juridik, kërkues i lejes për ndërtimin, riparimin, restaurimin apo shembjen e objektit, përpara marrjes së lejes së ndërtimit duhet të depozitojë një garanci financiare për llogari të NJQV-së, e cila nuk do të jetë më e vogël se 3% e vlerës së strukturës së objektit dhe përcaktohet me vendim të këshillit të NJQV-së.

Njësitë e qeverisjes vendore, më konkretisht Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në dokumentacionin e lëshimit të lejes për projektin e ndërtimit, riparimit, restaurimit apo shembjes, përcaktojnë se personi fizik ose juridik, të cilit i është dhënë leja për realizimin e projektit, duhet të provojë me dokumentacionin e nevojshëm përmbushjen e kërkesave sipas VKM Nr. 575, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e përfundimit të projektit të ndërtimit, riparimit, restaurimit apo prishjes së objektit, i cili krijon mbetje inerte.

Garancia financiare i kthehet subjektit fizik/juridik pa interes nga Bashkia, e cila ka lëshuar lejen e ndërtimit, pasi të provojë se mbetet inerte janë dorëzuar, sipas pikave 4, 5 dhe 6, të VKM Nr. 575 në landfillin ose në venddepozitimin e përkohshëm të përcaktuar nga Bashkia. Në rast të mospërmbushjes së kushteve të sipërpërmendura, Bashkia konfiskon garancinë financiare.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimit: Struktura e ngarkuar për llogaritjen e pagesës së garancisë financiare dhe vjeljen e saj është Drejtoria e Urbanistikës pranë Bashkisë Patos.

4. Taksa e tabelës

Taksa e tabelës zbatohet për të gjithë subjektet, të cilët vendosin tabela, të lëvizshme apo të palëvizshme, për të identifikuar veprimtarinë e tyre ose për qëllime reklamimi të veprimtarisë së tyre apo dhe për të tretë, që vendosen në pamjen ballore të vendodhjes së veprimtarisë, ose brenda territorit të përbashkët në qendrat tregtare, ose në hapësira jashtë vendodhjes së veprimtarisë, qofshin këto publike ose private.

- ❖ Baza e taksës së tabelës është çdo tabelë e standardizuar, tabela përmban shkronja, logo, simbole apo figura, që mundësojnë identifikimin e veprimtarisë së taksapaguesit, apo që shërbejnë për qëllim orientimi, reklamimi ose ekspozimi. Si bazë vlerësimi për llogaritjen e taksës, shërben sipërfaqja në metër katror që zë tabela në të gjithë shtrirjen e saj. Në rastin kur tabela përbëhet vetëm nga gërma të veçuara, simbole, logo apo figura të vendosura, të gdhendura, apo të pikturuara mbi një sipërfaqe ekzistuese, si mur, fasadë të jashtme të çdo lloji, shtyllë, kollonë, apo të ngjashme me to, dhe jo nga një sipërfaqe e vetme e shtrirë të shkruar, stampuar, apo pikturuar brenda saj, e cila vendoset mbi një sipërfaqe ekzistuese, si bazë vlerësimi për llogaritjen e taksës shërben sipërfaqja që zenë të gjitha shkronjat, figurat, logo dhe simbolet që formojnë tabelën.

Kur në sipërfaqen e tabelës identifikuese përfshihen edhe germa, simbole dhe figura për qëllime reklamimi të një apo më shumë produktesh apo shërbimesh që furnizohen nga vetë njësia ku është vendosur tabela, kjo tabelë vlerësohet si tabelë identifikuese dhe taksa llogaritet për këtë kategori tabelle. Në rast të kundërt, tabela vlerësohet si tabelë reklamimi dhe taksa llogaritet për tabelën për qëllime reklamimi. Taksa e tabelës për subjektet e reja paguhet nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, për pjesën e mbetur të vitit.

Në rast të përdorimit nga taksapaguesi të më shumë se një tabelle identifikuese, përveç atyre orientuese, vlerësohet si tabelë identifikuese vetëm ajo tabelë që është e trupëzuar ose jo në njësinë apo brenda territorit ku ushtrohet veprimtaria e taksapaguesit, ose që ndodhet më pranë njësisë, ose vetëm një nga tabelat, kur ka më shumë se një të tillë në njësinë apo territorin ku ushtrohet veprimtaria e tij. Çdo tabelë tjetër e tillë konsiderohet si tabelë për qëllime reklamimi dhe taksa llogaritet dhe paguhet për këtë kategori tabelle.

❖ Taksa e tabelës është taksë vjetore.

Tabelat ndahen në:

- Tabelë për qëllime identifikimi të veprimtarisë së subjektit, e trupëzuar ose jo, brenda territorit ku zhvillohet veprimtaria dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtarinë e të tretëve. Në të tilla tabela shënohet emri ose logo dhe/ose veprimtaria e subjektit. Në rastin e përdorimit të më shumë se një tabelle identifikuese, vetëm njëra do të konsiderohet e tillë.
- Tabelë për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e subjektit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim. Këto tabela shërbejnë vetëm si tabela orientuese dhe vendosen jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti, për orientimin e klientelës apo të publikut drejt vendndodhjes së veprimtarisë së subjektit.
- Tabelë për qëllime reklamimi, e lëvizshme ose e palëvizshme, e vendosur në pamje ballore ose jo ballore në vendin ku zhvillohet veprimtaria e subjektit, ose në hapësira të përbashkëta në qendrat tregtare, ose në hapësira të tjera publike apo private, si në tarraca, llozhe, ballkone, fasada, trotuare, shtylla, mbajtëse ajrore mbi pjesë të rrugëve qytetase apo kombëtare, etj., që kanë përmbajtje reklamimi për vete apo të tretët dhe që shërben si reklamë për të njoftuar, tërhequr vëmendjen ose për të joshur blerësit.
- Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panairë, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.

Bën përjashtim rasti kur tabela vendoset në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panairë, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj., për të cilat taksa llogaritet dhe paguhet vetëm për periudhën kohore të lejes së dhënë nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

Nivelet e taksës së tabelës sipas kategorizimeve të përcaktuara, jepen në tabelën 7.

Tabela 7

Nr	Llojet e tabelave	Nj/matëse	Niveli i taksës
1	Taksë tabelle për qëllime identifikimi të trupëzuara ose jo, brënda territorit ,ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve (ku shënohet emri dhe /ose aktiviteti i biznesit)		
a	Deri në 2 m2	Lekë/m2/vit	0
b	- Mbi 2m2 deri 10 m2		
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	Lekë/m2/vit	7 000
	-me ndricim të thjeshtë	Lekë/m2/vit	11 500
	-elektronike	Lekë/m2/vit	15 000
C	- Mbi 10m2 deri 20 m2		
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	Lekë/m2/vit	5 950
	-me ndricim të thjeshtë	Lekë/m2/vit	9 775
	-elektronike	Lekë/m2/vit	12 750
ç	- Mbi 20m2 deri 40 m2		
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	Lekë/m2/vit	3 850
	-me ndricim të thjeshtë	Lekë/m2/vit	6 325
	-elektronike	Lekë/m2/vit	8 250
d	- Mbi 40 m2		
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	Lekë/m2/vit	2 800
	-me ndricim të thjesht	Lekë/m2/vit	4 600
	-elektronike	Lekë/m2/vit	6 000
2	Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim		
	-tabela identifikuese	Lekë/m2/vit	120
3	Tabela për qëllime reklamimi e lëvizshme e palëvizshme		
	-e thjeshtë (me /pa ndriçim)	Lekë/m2/vit	13 500
	-elektronike	Lekë/m2/vit	27 000
4	Tabela në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura , panairë, spektakle, stenda reklamuese,banderola ,etj.		
	-të gjitha llojet e përmasave	Lekë/m2/ditë	1 000

Përfashtime

Përfashtohen nga pagesa e taksës së tabelës subjektet me statusin e Ambulantit.

Afatet e pagesës

Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar 30.06.2026, të paguajë shumën e detyrimit tatimor, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.

Struktura përgjegjëse për arkëtimin e kësaj takse

Ngarkohet Drejtoria e Urbanistikës për matjen e tabelave.

Ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Taksave Mjedisit dhe Turizimit për llogaritjet, dhe arkëtimin e kësaj takse.

5-Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël

- Çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal qarkullim më i vogël ose i barabartë me 8 000 000 (tetë milionë) lekë, i nënshtrohen detyrimeve të parashikuara në këtë kre.

-Të ardhurat gjithsej nga veprimtaria e biznesit të vogël nënkuptojnë çdo lloj të ardhure, të realizuar gjatë periudhës tatimore dhe përfshijnë, pa u kufizuar vetëm në to: të ardhurat e realizuara nga furnizimi i mallrave dhe shërbimeve, të ardhurat nga pjesëmarrjet, të ardhurat nga interesat, të ardhurat nga shfrytëzimi i pasurisë së luajtshme e të paluajtshme

- **Shkalla tatimore** e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm për tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim vjetor nga 0 (zero)deri në 8 (tetë) milionë lekë, është 0 (zero) lekë.

- **Deklarimi** Çdo tatimpagues, subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël është i detyruar që deri në 10 Shkurt të vitit që pason periudhën tatimore të dorëzojë një deklaratë vjetore tatimore, ku të jepen hollesisht të ardhurat gjithsej, shpenzimet e zbritshme, fitimi i tatueshëm, si dhe çdo holles tjetër e përcaktuar në udhëzimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës tatimore vjetore.

- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet Drejtorive Rajonale Tatimore, është e ngarkuar me vlerësimin, kontrollin, e tatimpaguesve, subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël.

KAPITULLI II : Taksat e ndara

Në zbatim të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore “ neni 25 i tij

shprehet:

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore marrin një përqindje nga taksat ose tatimet kombëtare që realizohen në juridiksionin e tyre, sipas përcaktimeve të këtij neni.
2. Taksat kombëtare që ndahen me njësitë e vetëqeverisjes vendore janë:
 - a) 97% për qind e të ardhurave nga taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme për individë, personat fizikë dhe juridikë.
 - b) 25% për qind e të ardhurave nga taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura.
 - c) 5% për qind e të ardhurave nga renta minerare, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për taksat kombëtare.
 - ç) 2% për qind e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale.
3. Të ardhurat e arkëtuara nga taksat e ndara transferohen te njësitë e vetëqeverisjes vendore deri në fund të muajit pasardhës.
4. Në rastet e ndryshimeve në politikën fiskale, që shoqërohen me ulje të niveleve, normave dhe taksave të ndara, njësitë e vetëqeverisjes vendore kompensohen financiarisht, në përputhje me nivelin e uljes së të ardhurave.

1.Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë

1. Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.

Taksa paguhet nga personi, që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

2. Baza e taksës mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet. Kategoritë e ndërtesave, për efekt të bazës së taksueshme, jepen në aneksin nr.3 që i bashkëlidhet këtij ligji. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror të bazës së taksës. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

3. Baza e taksës për kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitjes së tyre. Niveli i taksës caktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është 2 për qind. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

Tabela 8

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë.

Nr	Kategoria	Njësia matjes	Niveli i taksës
1	Ndërtesa banimi	Lekë/m ²	100
2	Ndërtesa për tregti dhe shërbime	Lekë/m ²	300
3	Ndërtesa të tjera	Lekë/m ²	200

Përfundime

Përrjashtohen nga pagimi i taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme:

1. Enti Kombëtar i Banesave, Ministria e Financave dhe organet e qeverisjes qendrore e vendore.
2. Personat, të cilët janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat vetjake, në mbështetje të ligjit nr.29/2023, "Për tatimin mbi të ardhurat".
3. Subjektet që dhurojnë pasuri të paluajtshme kur përfitues të drejtpërdrejtë janë:

a). institucionet dhe entet shtetërore e publike, qendrore e vendore.

b) bashkësitë fetare ose organizatat jofitimprurëse, kur dhurimi lidhet me atë pjesë të veprimtarisë së tyre pa qëllim fitimi. Në këto raste dhuruesi, pasi ka marrë vërtetimin nga përjashtimin nga taksa, bën regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të dhuruar. Në çastin e regjistrimit, dhuruesi paguan pjesën që i takon agjentit të taksave.

Në rastet kur pranohet nga vetë palët ose kur vërtetohet ligjërisht simulim i dhurimit për llogari të një shitjeje, për shmangie nga taksa, zbatohen taksa sa dyfishi i vlerës, pavarësisht nga përgjegjësitë e tjera sipas ligjeve në fuqi.

Struktura përgjegjëse për arkëtimin e kësaj takse

Vjelja e kësaj takse bëhet nga Agjensia Shtetërore e Kadastës (ish Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme), të cilat, në rolin e agjentit të taksave, përfitojnë 3 për qind të shumës së arkëtuar dhe diferencën e cila është 97 % e derdhit për llogari të buxhetit përkatës të Bashkisë në territorin e së cilës ndodhet pasuria, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.

2. Taksa vjetore e mjeteve të përdorura

- a) Taksa llogaritet sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9975 dt. 28.07.2008, "Për taksat kombëtare" i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.18 datë 23.08.2011 për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.26, datë 4.9.2008 "Për taksat kombëtare", të ndryshuar.
- b) Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor i ndan të ardhurat nga taksa e mjeteve të përdorura sipas njësive të qeverisjes vendore, mbështetur në vendbanimin e taksapaguesit që zotëron mjetin e transportit.
- c) Nga shuma e përgjithshme e të ardhurave mujore të arkëtuara nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura, drejtoritë rajonale të DRSHTRR-së, derdhin me anë të faturës për arkëtim, 25 % të këtyre të ardhurave në llogarinë bankare të degës së thesarit të rrethit ku është Njësia e Qeverisjes Vendore.
- d) Rakordimi i pagesës së taksës ndërmjet strukturave të DRSHTRR-së me organet tatimore vendore kryhet në bazë të regjistrit ditor të taksës vjetore të mjeteve të përdorura, formati i të cilit është i përcaktuar me Udhëzim të Ministrit të Financave.

Struktura përgjegjëse për arkëtimin e kësaj takse

Drejtoritë Rajonale të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DRSHTRR), të cilat janë agjent tatimor të mbledhjes së taksës vjetore të mjeteve të përdorura, mbledhin këtë taksë dhe e derdhin, brenda datës 30 të muajit pasardhës, për llogari të organeve tatimore të administratës qendrore dhe njësive të qeverisjes vendore.

3. Taksa e Rentës minerare

Taksa e rentës minerare caktohet sipas shtojcës nr. 2, që i bashkëlidhet ligjit nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar dhe është pjesë përbërëse e tij. Përqindja e rentës minerare për përmbajtjen e mineralit metalor në nënproduktin mineralar është në masën sa $\frac{2}{3}$ e normës së rentës së përcaktuar në shtojcën nr. 2, “Grupi i parë (I) Mineralet metalike” që i bashkëlidhet këtij ligji. Çdo person fizik apo juridik, që është i licencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrinë përgjegjëse për ekonominë, duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga/mbi/dhe nëntoka e territorit të Republikës së Shqipërisë.

Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare 5 për qind e të ardhurave nga renta minerare i takojnë pushtetit vendor ku zhvillohet veprimtaria. Të ardhurat nga renta minerare përdoren për investime për njësitë e qeverisjes vendore.

Pagesa e rentës minerare bëhet brenda datës 15 të muajit pasardhës, kur janë realizuar shitjet. Degët e doganave në rrethe ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët rajonale të tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit.

Agjentet për mbledhjen e taksës së rentës minerare janë Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Taksat arkëtohen nga agjentët e taksave, të përcaktuar në nenin 5 të ligjit, nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar dhe transferohen në llogaritë e drejtorive rajonale tatimore dhe të llogarive të njërive të qeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj.

2. Agjentët e taksave, për shërbimin që kryejnë, përfitojnë komision, të cilin e marrin në rrugë buxhetore. Ky komision llogaritet në përqindje mbi shumat e arkëtuara të taksave që kanë transferuar në llogari të drejtorisë rajonale tatimore dhe në buxhetin e njërive të qeverisjes vendore.

Ngarkohet Drejtoria e të Ardhurave Vendore për kryerjen e rakordimeve me agjentët e kësaj takse dhe arkëtimin e saj në llogari të Bashkisë Patos.

4. Tatimi mbi të ardhurat personale (TAP).

Njësitë e vetëqeverisjes vendore marrin 2% përqind e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale.

Udhëzimi mbi për procedurat e ndjekjes deri në kalimin e kësaj të ardhura në llogari të Njësive Vendore do të bëhet sipas udhëzimit të Ministrisë së Financave.

KAPITULLI III : Tarifat vendore

Ky kapitull trajton tarifat vendore në mënyrë nominale duke u nisur nga elementët:

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë të drejtë të vendosin tarifa për një shërbim që këto njësi ofrojnë apo për një të drejtë që u jepet individëve, personave fizikë dhe/ose juridikë.

2. Niveli i tarifës orientohet në mbulimin e kostos së shërbimit publik të ofruar nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

a) tarifa për shërbimet administrative dhe dhënien e licencave, lejeve e autorizimeve;

- b) tarifa të përkohshme, në përputhje me rrethana të përcaktuara në ligj;
- c) tarifa të tjera, të përcaktuara nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore;
- d) tarifa të përcaktuara në ligj.

1 .Tarifa e Pastrimit

Përkufizimi: Tarifës së pastrimit i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë/janë rezidentë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Patos dhe njësive të saj administrative.

Niveli i Tarifës së Pastrimit: Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese janë të shprehura si më poshtë:

1. Tarifa e Pastrimit për Biznesin

Tarifës së Pastrimit i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Patos.

Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese të Tarifës së Pastrimit janë si më poshtë:

Tabela nr.1

Nr	Kategoritë	Biznesi i Vogël				Biznesi i Madh	
		Deri ne 5.000.000 lekë xhiro		Mbi 5.000.001.der në 8.000.000 lekë xhiro			
		Bashkia	Njësi Admin.	Bashkia	Njësi Admin.	Bashkia	Njësi Admin.
	BIZNESI						
1	PËR ÇDO NJËSI TREGTIMI						
	Për tregtim bulmet mish, peshk, fruta, perime, ushqimore.	11,000	8,500	17,000	14,000	35,000	35,000
	Shitje artikuj industrialë (veshje, parfumeri, argjendari e të tjera të ngjashme).	11,000	8,500	17,000	14,000	35,000	35,000
	Për Restorante, Bar - bufe, Kafene, Piceri, fast food, e të tjera të ngjashme me to.	11,000	8,500	19,000	14,500	35,000	35,000
	Byrektore	11,000	8,500	17,000	14,000	25,000	25,000

	Njësi tregtimi lëndësh djegëse, karburant, gaz. Për subjektet SH.A.	11,000	8,500	39,000	29,500	55,000 210,000	55,000 210,000
	Njësi tregtimi materiale ndërtimi, pllaka, hidrosanitare, tulla, cemento, gëlqere, tulla e të tjera të ngjashme.	11,000	8,500	19,000	14,500	35,000	35,000
	Magazina, dyqane që realizojnë shitje me shumicë (Njësi tregtimi me shumicë), supermarkete, tregje private.	11,000	8,500	39,000	29,500	55,000	55,000
2	PËR ÇDO NJËSI SHËRBIMI						
	Riparime elektro shtëpiake, riparime rrobaqepsie, berber, këpucar.	11,000	8,500	14,000	11,000	25,000	25,000
	Servis celularësh.	11,000	8,500	14,000	11,000	25,000	25,000
	Servis automjeteve, autoshkolla.	11,000	8,500	14,000	11,000	25,000	25,000
	Agjensi këmbim valute, agjensi turistike, agjensi transporti, agjensi doganore, Kompani Sigurimesh, polici private, pastrim kimik, salla lojrash (aerobi, gjimnastikë, palestër), Studio fotografike.	11,000	8,500	14,000	11,000	30,000	30,000
	Salla lojrash për fëmijë, lojra me kompjuter.	11,000	8,500	14,000	11,000	25,000	25,000
	Sallon bukurie, shkollë parukerie, estetist.	11,000	8,500	14,000	11,000	25,000	25,000
	Njësi shërbimi marangoz.	11,000	8,500	14,000	11,000	25,000	25,000
	Institucionet jopublike të edukimit (shkolla, kopështe, çerdhe, kurse profesionale të gjuhëve të huaja e të tjera të ngjashme).	11,000	8,500	14,000	11,000	35,000	35,000
	Shërbime në Klinikat e specialiteteve të ndryshme	12,000	9,000	19,000	14,500	35,000	35,000

	mjekësore, shërbime në laboratorë diagnostifikimi.						
	Shitje produkte farmaceutike (farmaci), depo farmaceutike.	12,000	9,000	29,000	21,500	45,000	45,000
	Hotele/motele dhe çdo njësi akomoduese.	12,000	9,000	34,000	25,000	55,000	55,000
	Për çdo parking privat dhe lavazh	10,000	8,500	14,000	11,000	25,000	25,000
	Njësi të tjera të cilat nuk përmenden më lart.	10,000	8,500	14,000	11,000	35,000	35,000
	Ndërmarrjet (Sh.a apo SHPK) të shërbimit për energji elektrike e telefonisë, postë, Ujësjellës.	120,000					
	Institucione shtetërore.	100,000					
	Shërbimi spitalor, diagnostikimi, Shtetëror apo privat.	170,000					
	Banka, filiale bankash, Kompani telekomunikacioni.	120,000					
	Agjensi financiare, filiale agjensish.	40,000					
	Televizione private, radio	30,000					
	Shoqata jofitimprurëse, Fondacione, organizata joqeveritare.	15,000					
	Ambulantë.	6,000					
3	PËR ÇDO NJËSI PRODHIMI						
	Prodhime ushqimore buka, ëmbëlsira, bulmeti, pije etj.	11,000	8,500	19,000	15,500	29,000	29,000
	Prodhim konfeksione, veshje, këpucë, Salla per organizim eventesh etj.	11,000	8,500	39,000	29,500	150,000	150,000
	Përpunim metalesh, druri, letre, plastmasi, duralumini, kartoni etj.	11,000	8,500	19,000	19,500	55,000	55,000
	Komplekse për rritjen dhe therjen e kafshëve, shpendëve, ferma etj.						

		50,000					
	Prodhim materiale ndërtimi, tulla, tjegulla, çimento, furra gëlqere etj.	80,000					
4	PROFESIONE TË LIRA						
	Avokat, Noter, Përkthyes, Mjek, mjek laborant, stomatolog, farmacist, ekspert kontabilist, mësues, veteriner, inxhinier, arkitekt, projektues, agjent sigurimesh, e të tjera profesione të lira të cilat ushtrohen në ambiente të ndryshme.	12,000	9,000	24,000	19,000	39,000	39,000
5	Biznesi i madh me aktivitet ndërtimi.	550,000					
	PËR ÇDO KANTIER, ME LEJE NDËRTIMI- ZHVILLIMI NË RAPORT ME KOHËZGJATJEN E PËRFUNDIMIT TË NDËRTIMIT DHE VLERËN E TIJ DERI NË MARRJEN E ÇERTIFIKATËS SË PËRDORIMIT						
	Deri në 1.000.000					7,000	
	1.000.000- 2.000.000					12,000	
	2.000.000- 3.000.000					19.000	
	3.000.000- 4.000.000					25.000	
	4.000.000- 5.000.000					30.000	
	Deri në 5.000.000					30.000	
	5.000.000 - 15.000.000					42.000	
	15.000.000 - 30,000.000					60.000	
	30.000.000 - 50,000.000					75.000	
	50.000.000 - 100.000.000					95.000	
	100.000.000 - 500.000.000					120.000	
	Mbi 500.000.000					550.000	
6	BIZNES ME AKTIVITET NXJERRJE HIDROKARBURESH ME SELI DHE FILIALET BRENDIA TERRITORIT TË BASHKISË						
	Kompania Albpetrol sha.					3.500.000	
	Kompania Bankers Petroleum LTD.					3.500.000	
	TERRAOIL SWISS.					2.000.000	

7	Subjekte që ushtrojnë aktivitet brenda territorit të Bashkisë si karierë Rere bituminoze guri, shfrytëzim argjilash, etj të ngjashme, zhavorre.	150,000
8	Subjekte që kryejnë shërbime si projekte, studime në fushën e hidrokarbureve.	170,000

Tabela nr.1.1

	a) Automjete deri në 5 vende	4,000
	b) Automjete 6 deri në 9 vende	5,000
	c) Automjete 10 deri në 25 vende	5,500
	d) Automjete 26 deri në 42 vende	7,000
	e) Automjete mbi 42 vende	9500
	Transport mallrash	Lekë/vit
	a)Automjete deri në 2 ton	3.500
	b) Automjete mbi 2 deri në 5 ton	4.500
	c) Automjete mbi 5 deri në 10 ton	5.500
	d) Automjete mbi 10 deri në 16 ton	6.500
	e)Automjete mbi 16 ton	8.500

Mënyra e pagesës

Detyrimi për Tarifën e Pastrimit është vjetor.

Afatet e pagesës

Detyrimi paguhet brenda datës 30.06.2026.

Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar 30.06.2026, të paguajë shumën e detyrimit tatimor, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.

Për subjektet e regjistruara rishtaz detyrimi tatimor do të llogaritet nga muaji korrent i regjistrimit pranë QKB për të gjitha kategoritë e biznesit,afati i pageses brenda 30 diteve nga rregjistrimi ne QKB.

Nëse subjekti taksapagues pushon veprimtarinë gjatë vitit, detyrimi tatimor llogaritet duke shumëzuar tarifën për vitin e plotë kalendarik me numrin e muajve të plotë gjatë të cilëve veprimtaria është kryer (përfshirë muajin përkatës për të cilin është bërë kërkesa) dhe duke e pjesëtuar atë me 12 muajt e vitit kalendarik fiskal).

Përfitojnë lehtësira fiskale për Tarifën e Pastrimit kjo kategori:

1. Emigrantët të cilët do të hapin aktivitet ekonomik gjatë vitit 2026 niveli i tarifës do të jetë 0 lekë.
2. Bizneset e reja që do të hapen ku numri i të punësuarve do të jetë mbi 10 gjatë vitit 2026 niveli i tarifës do të jetë 0 lekë.
3. Për persona studentë të diplomuar në Universitetet shtetërore vendase të diplomuar gjatë vitit 2026 niveli i tarifës do të jetë 0 lekë.

4. Fermerët e pajisur me NIPT si persona fizik janë të përjashtuar nga pagesa e tarifës.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e Tarifës Pastrimit janë:

Drejtoria e të Ardhurave Vendore, specialistët e të ardhurave vendore pranë Njësive Administrative.

E ardhura nga Tarifa e Pastrimit i takon 100% Bashkisë.

2. Tarifa e Gjellbërimit

Tarifës së Gjellbërimit i nënshtrohen të gjithë personat fizik ose juridik, vendas ose të huaj,që ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit në njësinë Administrative Patos dhe Zharrëz, përjashtohet nga këto tarifa Njësia Administrative Ruzhdie.

Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese të Tarifës së Gjellbërimit janë si më poshtë:

Tabela nr.2

	Kategoritë /Nënkategoritë	Bashkia	Njësia Administrative Zharrëz	Njësia Administrative Ruzhdie
1.	Për biznesin e vogël deri 5.000.000 lekë xhiro	2,500	2,200	0
2.	Për biznesin e vogël mbi 5.000.000 deri në 8.000.000 lekë xhiro	4,000	3,400	0
3.	Për biznesin e madh	7,000	6,000	0
4.	Për institucionet shtetërore	25,000		
5.	Biznes me aktivitet nxjerrje dhe/ose përpunim hidrokarburesh me seli dhe filialet brenda territorit	150,000		
6	Për subjektet SH.P.K dhe SH.A	25,000		

Mënyra e pagesës

Detyrimi për Tarifën e Gjellbërimit është vjetor.

Afatet e pagesës

Detyrimi paguhet brenda datës 30.06.2026.

Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar 30.06.2026, të paguajë shumën e detyrimit tatimor , detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer.

Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.

Për subjektet e regjistruara rishtaz detyrimi tatimor do të llogaritet nga muaji korrent i regjistrimit pranë QKB për të gjitha kategoritë e biznesit, afati i pagesës brenda 30 diteve nga rregjistrimi ne QKB.

Nëse subjekti taksapagues pushon veprimtarinë gjatë vitit, detyrimi tatimor llogaritet duke shumëzuar tarifën për vitin e plotë kalendarik me numrin e muajve të plotë gjatë të cilëve veprimtaria është kryer (përfshirë muajin përkatës për të cilin është bërë kërkesa) dhe duke e pjesëtuar atë me 12 muajt e vitit kalendarik fiskal).

Përfitojnë lehtësira fiskale për Tarifën e Gjellbërimit kjo kategori:

1. Emigrantët të cilët do të hapin aktivitet ekonomik gjatë vitit 2026 niveli i tarifës do të jetë 0 lekë.
2. Bizneset e reja që do të hapen ku numri i të punësuarve do të jetë mbi 10 gjatë vitit niveli i tarifës do të jetë 0 lekë.
3. Për persona studentë të diplomuar në Universitetet shtetërore vendase të diplomuar gjatë vitit 2026 niveli i tarifës do të jetë 0 lekë.
4. Fermerët e paisur me NIPT si persona fizik janë të përjashtuar nga pagesa e tarifës.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e Tarifës Gjellberimit janë:

Drejtoria e të Ardhurave Vendore, specialistët e të ardhurave vendore pranë Njësive Administrative.

E ardhura nga Tarifa e Gjellbërimit i takon 100% Bashkisë.

3. Tarifa e Ndriçimit

Tarifës së Ndriçimit i nënshtrohen të gjithë personat fizik ose juridik, vendas ose të huaj, që ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit në njësinë Administrative Patos dhe Zharrëz, përjashtohet nga këto tarifa Njësia Administrative Ruzhdie.

Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese të Tarifës së Ndriçimit janë si më poshtë:

Tabela nr.3

	Kategoritë /Nënkategoritë	Bashkia	Njësia administrative Zharrëz	Njësia administrative Ruzhdie
1.	Për biznesin e vogël deri 5.000.000 lekë xhiro	2,500	2,200	2,200
2.	Për biznesin e vogël mbi 5.000.000 deri në 8.000.000 lekë xhiro	4,000	3,400	3,400
3.	Për biznesin e madh	7,000	6,000	6,000
4.	Për institucionet shtetërore	25,000		

5.	Biznes me aktivitet nxjerrje dhe/ose përpunim hidrokarburesh me seli dhe filialet brenda territorit	150,000
6	Për subjektet SH.P.K dhe SH.A	25,000

Mënyra e pagesës

Detyrimi për Tarifën e Ndriçimit është vjetor.

Afatet e pagesës

Detyrimi paguhet brenda datës 30.06.2026.

Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar 30.06.2026, të paguajë shumën e detyrimit tatimor, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.

Për subjektet e regjistruara rishtaz detyrimi tatimor do të llogaritet nga muaji korrent i regjistrimit pranë QKB për të gjitha kategoritë e biznesit, afati i pageses brenda 30 diteve nga rregjistrimi në QKB.

Nëse subjekti taksapagues pushon veprimtarinë gjatë vitit, detyrimi tatimor llogaritet duke shumëzuar tarifën për vitin e plotë kalendarik me numrin e muajve të plotë gjatë të cilëve veprimtaria është kryer (përfshirë muajin përkatës për të cilin është bërë kërkesa) dhe duke e pjesëtuar atë me 12 muajt e vitit kalendarik fiskal).

Përfitojnë lehtësira fiskale për Tarifën e Ndriçimit kjo kategori:

1. Emigrantët të cilët do të hapin aktivitet ekonomik gjatë vitit 2026 niveli i tarifës do të jetë 0 lekë.
2. Bizneset e reja që do të hapen ku numri i të punësuarve do të jetë mbi 10 gjatë vitit 2026 niveli i tarifës do të jetë 0 lekë.
3. Për persona studentë të diplomuar në Universitetet shtetërore vendase të diplomuar gjatë vitit 2026 niveli i tarifës do të jetë 0 lekë.
4. Fermerët e paisur me NIPT si persona fizik janë të përjashtuar nga pagesa e tarifës.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e Tarifës Ndriçimit janë:

Drejtoria e të Ardhurave Vendore, specialistët e të ardhurave vendore pranë Njësive Administrative.

E ardhura nga Tarifa e Ndriçimit i takon 100% Bashkisë.

4 . Tarifa e Ndotjes Mjedisore/Përmirësim Mjedis

Ndotësi Pagan!

Bazuar në ligjin nr.68/2017, ”Për Financat e Vetëqeverisjes vendore” neni 17 i tij shprehet:

Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të vendosin tarifa për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit. Niveli i këtyre tarifave përcaktohet me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe vendoset për individët, personat fizikë ose juridikë që ushtrojnë aktivitete, efekti i të cilave në mjedis është i qartë, i matshëm dhe i atribueshëm për aktivitetin në fjalë.

Duke parë që ndotja e ajrit, ujit dhe tokës nga aktiviteti i disa lloj bizneseve ka ndikim në jetën e komunitetit, propozojmë për ndotjen që këto subjekte shkaktojnë të tarifohen sipas nivelit të paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr.4 Niveli i tarifave të ndotjes

Nr	Lloji i aktivitetit	Tarifa
1	Subjektet e nxjerrjes dhe përpunimit të hidrokarbureve	200 lekë/m ²
2	Furra Gelqere, Fabrika Prodhimi me perdorim lende diegse me baze hidrokarure.	50,000 lekë/vitë
2	Pikat e shitjes së gazit të lëngshëm me shumicë	30,000 lekë/vitë
3	Pikat e shitjes së gazit të lëngshëm me pakicë	5,000 lekë/vitë

Ngarkohet sektori i mjedisit , Drejtoria e Urbanistikës, Drejtoria e të Ardhurave Vendore për verifikimin dhe saktësimin e sipërfaqeve të subjekteve që tarifohen sipas nivelit tarifës të tabelës së mësipërme.

Mënyra e pagesës

Detyrimi për Tarifën është vjetor.

Afatet e pagesës

Detyrimi paguhet brenda datës 30.06.2026.

Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar 30.06.2026, të paguajë shumën e detyrimit tatimor , detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 0,06 përqind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike. Nëse subjekti taksapagues pushon veprimtarinë gjatë vitit, detyrimi tatimor llogaritet në raport me muajt që subjekti është aktiv.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e Tarifës së Ndotjes është:

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Taksave Mjedisit dhe Turizimit.

5. Tarifa e Pastrimit për Familjet

- a. Tarifat paguhen nga “çdo familje rezidente efektive” në Bashkinë Patos. Për këtë do të marrim në konsideratë kontratat me OSHE.
- b. Detyrimi i tarifës është vjetor dhe paguhet për vitin kalendarik .
- c. Për çdo familje të re të regjistruar gjatë vitit detyrimi llogaritet nga muaji korent i regjistrimit.
- d. Për familjet jo efektive të cilat pas verifikimeve të përsëritura për njësinë administrative Patos dhe nga njësitë e tjera administrative nuk banojnë në adresën e deklaruar janë të përjashtuara nga Tarifa e Pastrimit.
- e. Familjet pajisen me librez taksash .

Tabela nr.5

Kategoritë	Niveli i tarifës së Pastrimit për Familjet.
Njësia Administrative Patos: 1 Familje e përbërë me 1 deri 2 persona sipas çertifikatës familjare. 2 Familje e përbërë me 3 dhe më shumë persona sipas çertifikatës familjare.	3,900 lekë/vitë 5,100 lekë/vitë
Njësia Administrative Zharëz: 1 Familje e përbërë me 1 deri 2 persona sipas çertifikatës familjare. 2 Familje e përbërë me 3 dhe më shumë persona sipas çertifikatës familjare.	3,900 lekë/vitë 5,100 lekë/vitë
Njësia Administrative Ruzhdië: Fshati Ruzhdië	1,500 lekë/vitë

Fshati Gjinoqarë	1,500 lekë/vitë
Fshatrat Drenie, Kasnicë dhe Siqecë	0 lekë /vitë

Mënyra e pagesës

Detyrimi për Tarifën e Pastrimit për Familjet është vjetor.

Afati i pagesës është deri në datë 30 Dhjetor të vitit kalendarik.

Përfitojnë lehtësira fiskale për Tarifën e Pastrimit për Familjet si më poshtë:

- Familjet e veteranëve niveli i tarifës do të jetë 0 lekë (theksojmë nuk përfitojnë pasardhës veteranësh).
- Familjet që kanë persona me PAK niveli i tarifës do të jetë 0 lekë .
- Familjet e të përndjekurve politik niveli i tarifës do të jetë 0 lekë.
- Familjet që janë në skemën e ndihmës ekonomike niveli i tarifës do të jetë 0 lekë.
- Familjet ku janë vetëm pensionistë sipas çertifikatës familjare niveli i tarifës do të jetë 0 lekë.

Për të përfituar nga lehtësitat fiskale:

Këto grupe duhet të dorëzojnë pranë inspektorit të taksave-tarifave vendore këto dokumenta.

- Librezën e veteranit ose invalidit të luftës,(fotokopje)
- Statusin e invalidit të punës, (fotokopje)
- Statusin e të verbrit, të sëmurëve paraplegjikë e tetraplegjikë, (fotokopje)
- Stausin e të përndjekurve politik, (fotokopje)
- Vërtetimin nga Drejtoria e Ndihmës Ekonomike pranë Bashkisë ose të Njesisë Administrative si përfituesit të ndihmës ekonomike
- Librez e pensionit, (fotokopje)
- Çertifikatën familjare

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e Tarifës së Pastrimit për Familjet janë:

- Për Njësinë Administrative Patos është punonjësi i sportelit të ardhurave vendore.
- Për Njësinë Administrative Zharrëz është specialisti i të ardhurave vendore pranë kësaj njësie.
- Për Njësinë Administrative Ruzhdie është specialisti i të ardhurave vendore pranë kësaj njësie.

Përrjashtohen nga pagesa e gjobës për vonesë në pagesë të gjithë taksapaguesit familjarë.

5.1 Tarifa për Shërbimin Komunitar

Tarifat paguhen nga “çdo familje rezidente efektive” në Bashkinë Patos. Për këtë do të marrim në konsideratë kontratat me OSHE.

- Detyrimi i tarifës është vjetor dhe paguhet për vitin kalendarik .
- Për çdo familje të re të regjistruar gjatë vitit detyrimi llogaritet nga muaji korent i regjistrimit.
- Për familjet jo efektive të cilat pas verifikimeve të përsëritura për njësinë administrative Patos dhe nga njësitë e tjera administrative nuk banojnë në adresën e deklaruar janë të përjashtuara nga Tarifa e Shërbimit.
- Familjet pajisen me librez taksash .

Tabela nr.5.1

Kategoritë	Niveli i tarifës së Shërbimit Komunitar.
Njësia Administrative Patos	1,500 lekë/vitë
Njësia Administrative Zharëz	1,500 lekë/vitë
Njësia Administrative Ruzhdië:	
Fshati Ruzhdië	800 lekë/vitë
Fshati Gjinoqarë	800 lekë/vitë
Fshati Drenie, Kasnicë dhe Siqecë	0 lekë/vitë

Mënyra e pagesës

Detyrimi për Tarifën e Shërbimit për komunitetin është vjetor.

Afati i pagesës është deri në datë 30 Dhjetor të vitit kalendarik.

Përfitojnë leftësira fiskale për Tarifën e Shërbimit familjar si më poshtë:

- Familjet e veteranëve niveli i tarifës do të jetë 0 lekë (theksojmë nuk përfitojnë pasardhës veteranësh)

- Familjet që kanë persona me PAK niveli i tarifës do të jetë 0 lekë .
- Familjet e të përndjekurve politik niveli i tarifës do të jetë 0 lekë.
- Familjet që janë në skemën e ndihmës ekonomike niveli i tarifës do të jetë 0 lekë.
- Familjet ku janë vetëm pensionistë sipas çertifikatës familjare niveli i tarifës do të jetë 0 lekë.

Për të përfituar nga lehtësirat fiskale:

Këto grupe duhet të dorëzojnë pranë inspektorit të taksave-tarifave vendore këto dokumenta.

- Librezën e veteranit ose invalidit të luftës,(fotokopje)
- Statusin e invalidit të punës, (fotokopje)
- Statusin e të verbrit, të sëmurëve paraplegjikë e tetraplegjikë, (fotokopje)
- Stausin e të përndjekurve politik, (fotokopje)
- Vërtetimin nga Drejtoria e Ndihmës Ekonomike pranë Bashkisë ose të Njesisë Administrative si përfituesit të ndihmës ekonomike
- Librez e pensionit, (fotokopje)
- Çertifikatën familjare

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e Tarifave të Shërbimit komunitar janë:

- Për Njësine Administrative Patos është punonjësi i sportelit të ardhurave vendore.
- Për Njësine Administrative Zharrëz është specialisti i të ardhurave vendore pranë kësaj njësie.
- Për Njësine Administrative Ruzhdie është specialisti i të ardhurave vendore pranë kësaj njësie.

Përfshihen nga pagesa e gjores për vonesë në pagesë të gjithë taksapaguesit familjarë.

6. Tarifa për Zënien e Hapësirës Publike dhe të Fasadave

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore vendosin tarifa për zënien e hapësirës publike dhe të fasadave si më poshtë:

- a) për zënien e hapësirës në zonat publike ose para mjediseve të biznesit, për qëllime biznesi, përfshirë këtu tavolinat jashtë për bare dhe restorante.
- b) për përdorimin e tabelave të reklamave.
- c) për zënien e hapësirave të parkimit për mjetet motorike.
- ç) për zënien e sipërfaqeve për kamping, ngritje tendash dhe mjete të tjera për përdorim të përkohshëm.
- d) për zënien e hapësirës publike për mbajtjen e materialeve të ndërtimit.
- dh) tarifa të tjera, që mund të vendosen me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

2. Në vendosjen e këtyre e tarifave, si rregull, ndiqen këto parime dhe kritere:

- a) vendndodhja (zona) ku ushtrohet veprimtaria, për të cilën vendoset tarifa.

b) karakteristika të tjera objektive dalluese të personave fizikë ose juridikë që zënë hapësirën publike.

3. Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore përcakton, me vendim, nivelin e tarifave vendore, zonat dhe përdoruesit, përfshirë përjashtimet e lehtësimet, afatet dhe metodat e pagesës së tarifave.

Baza e tarifës për zënie e hapësirave publike është sip.m² e cila vihet në shfrytëzim nga individë dhe subjekte për qëllime biznesi.

Tab nr.6

Nr.	Kategorit /Nënkategorit	Niveli i tarifës	
		Bashkia	Njësitë Administrative
1.	Organizim spektakli dhe panaire të ndryshme	100 lekë/m ² /muaj	50 lekë/m ² /muaj
2	Zënie e hapësirës publike për qëllime biznesi si vendosje mallrash jashtë vendit të tregtimit, vendosje tavolinash,sipërfaqe e zënë me platforma,sipërfaqe të rrethuar me vazo me lule, bime dekorative, me kangjella, drurë dekorativ, kufizime me plasmasë dhe sende të tjera, etj të ngjashme me to.	200 lekë/m ² / muaj	100 lekë/m ² /muaj

Detyrimi i tarifës përlllogaritët si shumëzim i bazës (sipërfaqes) me nivelin tregues të saj.

Pagesa e tarifës për zënie të hapësirës publike.

a) Për rastin e përdorimit të truallit (hapësirë publike) me qëllime organizimin e spektakleve ose panaireve të ndryshme, detyrimi është në raport me kohën e përdorimit sipas lejes së dhënë.

b) Për rastin e përdorimit të truallit (hapësirë publike) për qëllime ushtrim aktiviteti tregtar, si vendosje mallrash jashtë vendit të tregtimit, sipërfaqe e zënë me platforma, sipërfaqe të rrethuar me vazo me lule, bimë dekorative, me kangjella, drurë dekorativ, kufizime me plasmasë dhe sende të tjera, etj. të ngjashme me to, detyrimi është në raport me muajt që do ta përdorësh këtë hapësirë sipas kontratës.

c) Drejtoria e Urbanistikës ngarkohet për hartimin e dokumentacionit dhe përcaktimin e sipërfaqeve dhe dhënien e lejes.

d) Sektori juridik ngarkohet për përgatitjen dhe lidhjen e kontratës.

c) Pagesa kryhet me lidhjen e kontratës .

Struktura e ngarkuar për llogaritjen dhe lëshimin e autorizimit të pagesës për tarifën e hapësirës publike është Drejtoria e Urbanistikës .

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së hapësirës publike është Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Taksave Mjedisit dhe Turizmit pranë Bashkisë si dhe Njësitë Administrative për territorin e tyre.

Lehtësirat tatimore

Taksapaguesit përfitojnë kushte lehtësuese kur:

1. Kur paguajnë tarifën e zënies të hapësirës publike me afat 6-mujor dhe paguajnë të plotë detyrimin, përfitojnë reduktimin në masën 5 % të vlerës së detyrimit.
2. Kur paguajnë tarifën e zënies të hapësirës publike me afat 12-mujor dhe paguajnë të plotë detyrimin përfitojnë reduktimin në masën 10 % të vlerës së detyrimit.

7. TARIFA PËR PËRDORIMIN E TREGJEVE TE LIRA

Tarifës së Tregut i nënshtrohen të gjithë subjektet, të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre në hapësira e tregje publike të cilët janë në administrim të Bashkisë Patos. Baza e tarifës të tregut është sipërfaqja në m², e cila vihet në shfrytëzim për tregtimin e artikujve të ndryshëm brenda territorit të përcaktuar. Tarifa llogaritet si detyrim ditor i taksapaguesit. Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese të tarifës në tregjet e lira janë si më poshtë:

Tabela nr. 7.

1	Tarifë për përdorim të tregut të lirë të qytetit Patos, Zharëz: a) tregëtim mallra industrial , fruta- perime, deri ne 2 m ² a) tregëtim mallra industrial , fruta perime, mbi 2-4 m ² b) tregëtim mallra industrial , fruta- perime, mbi 4 m ²	 50 lekë/ ditë 100 lekë/ditë 200 lekë/ ditë
---	--	--

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e Tarifës së Tregut janë:

Për Njësinë Administrative Patos Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Taksave Mjedisit dhe Turizmit.

Për Njësinë Administrative Zharëz, Ruzhdie, janë specialistët e të ardhurave vendore pranë këtyre njësive.

8.TARIFAT E PARKIMIT

Struktura e ngarkuar për lëshimin e autorizimit të pagesës për tarifën do të jetë Drejtoria e Urbanistikës.

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e Tarifës së Parkimit të Automjeteve është Drejtoria e Urbanistikës në bashkëpunim me Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik Taksave Mjedisit dhe Turizmit në Bashki.

Tabela nr.8

NR	Emërtimi	Vlera e tarifës
1	Për autovetura të licësuara për taksi (me vende qëndrimi të përcaktuara) - autovetura taksi 8 + 1 - autovetura taksi 4 + 1	5.000 lekë / vit 4.000 lekë / vit
2	Për autobuza të shoqërive të transportit (pa parkim të rezervuar) - autobusë deri në 30 vende - autobusë mbi 30 vende	5.000 lekë / vit 6.000 lekë / vit
3	Për mjete transporti (pa parkim të rezervuar) - automjet transport malli deri 3,5 ton - automjet transport malli nga 3,5 ton deri në 8 ton - automjet transport malli nga 8 ton deri në 14 ton - automjet transport malli mbi 14 ton	2.200 lekë / vit 2.700 lekë / vit 3.500 lekë / vit 4.000 lekë / vit
4	Taksë parkimi të rezervuar	30.000 lekë / vit

9. Tarifa për shërbimin në fushën e transportit të pasagjerëve dhe mallrave

Tabela nr. 9

		lekë				
Nr.	Kategoritë	Njësia matëse	Afati 1-vjeçar	Afati 3-Vjeçar	Afati 5 - vjeçar	Afati 10 vjeçar
2.1	Transport mallrash brenda vendit					
2.1.a	Licënsë për transport mallrash për të tretë dhe me qera Person Juridik	Për licëncë	8000	24000	30000	-
2.1.b	Licënsë për transport mallrash për të tretë dhe me qera Person Fizik	Për licëncë	2000	8000	10000	-
2.1.c	Çertifikatë për transport mallrash brenda vendit për të tretë dhe me qera Person Juridik	Ton/kapacitet	200	-	-	-
2.1.d	Çertifikatë për transport mallrash brenda vendit për llogari të vetë Personit Fizik	Ton/kapacitet	200	-	-	-
2.1.e	Çertifikatë për transport mallrash të rrezikshme për të tretë dhe me qera Persona Fizik dhe Juridik	Ton/kapacitet	200	-	-	-
	Çertifikatë për mjet tërheqës	Për mjet	1500	-	-	-
2.2	Transport udhëtarësh brenda vendit					
2.2.a	Licënsë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetëse (urban)	Për linjë	8.000	-	-	80000
	Licënsë për kryerjen e shërbimeve të rregullta të specializuara	Për linjë	4000	-	20000	-
	Licënsë për shërbimin vajtje ardhje (lavjers) të udhëtarve tarifit	Për linjë	4000	-	20000	-
2.2.b	Certifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetëse.	Për mjet	1000	-	-	-
2.2.c	Licënsë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rrethqytetëse.	Për linjë	8000	12000	-	-
2.2.d	Certifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rrethqytetëse	Për mjet	1500	-	-	-
	Çertifikatë për kryerjen e shërbimeve të rregullta të specializuara të udhëtarve	Për mjet	1500	-	7500	-

	Çertifikatë për kryerjen e shërbimeve vajtje – ardhje (lavjerse) të udhetarve	Për mjet	1500	-	7500	-
2.2.g	Licencë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt ndërqytetese brenda qarkut	Për linjë	15000	45000	-	-
2.2.h	Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt ndër qytetëse brenda qarkut	Për mjet	1500	-	-	-
2.2.i	Çertifikatë për transporte të specializuara udhëtarësh brenda vendit.	Për mjet	1500	-	-	-
2.2.j	Licencë për transport udhëtarësh me taksi	Për mjet	-	-	20000	-
2.2.k	Autorizim për taksi (8+1)	Për mjet	5000	-	-	-

Licensat dhe çertifikatat përkatëse, jepen me afat tre vjeçar dhe pesë vjeçar subjekteve juridikë ose fizikë të licensuar si biznes transporti ose si biznes tjetër të cilit i vihet në dispozicion mjeti.

Për vjeljen e këtyre tarifave ngarkohet Drejtoria e Urbanistikës, pas rakordimit për shlyerjen e detyrimeve tatimore me Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik Taksave Mjedisit dhe Turizimit.

10.Tarifë për veprimtari të tjera

Tabela nr.10

Nr.	Emërtimi	Njësia	Miratohet
3.1.a	Autorizim për hyrje dalje për stacionet e shitjes së karburanteve. (një vjeçare)	Për autorizim	5000
3.1.b	Autorizim i përkohshëm mujor	Për autorizim	200
3.2.	Dhënie autorizimi për lëvizje të automjeteve mbi 3,5 ton brenda unazës për periudha të përkohshme.		
3.2.a	Automjete masa maksimale e autorizuar mbi 3,5 T – = 7,5 T	Për autorizim	3.000 lekë/vit ose 250 lekë/muaj
3.2.b	Automjete masa maksimale e autorizuar mbi 7,5 T – = 12 T	Për autorizim	6.000 lekë/vit ose 500 lekë/muaj
3.2.c	Automjete masa maksimale e autorizuar mbi 12 T – = 18 T	Për autorizim	8.400 lekë/vit ose 700 lekë/muaj
d	Automjete masa maksimale e autorizuar mbi 18 T	Për autorizim	12.000 lekë/vit Ose 1000 lekë/muaj

Për sa më sipër jemi mbështetur në udhezimin nr.15 datë 24.07.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licensave, autorizimeve dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor” i ndryshuar.

Shënim: Për dublikate me të njëjtën përmbajtje dhe afat vlefshmërie paguhet 30 % e vlerës së plotë.

Struktura e ngarkuar për lëshimin e autorizimit të pagesës për Tarifën e Transportit është Drejtoria e Shërbimeve Publike.

11. Tarifa për dhënien e lejes ushtrim veprimtarie

Tabela nr. 11		lekë/vit	
Nr.	Emërtimi	Njësia	
1.	Lavazho	Për leje	5000
2.	Leje për ushtrim veprimtarie tregtim ambulant	Për leje	2000
3.	Leje për zënien e hapësirave publike për qëllime biznesi	Per leje	7000

Shënim: Për dublikatë me të njëjtën përmbajtje dhe afat vlefshmërie paguhet 30 % e vlerës së plotë.

Lejet jepen nga Drejtoria e Urbanistikës. Një kopje e lejeve i dorëzohet Drejtorisë Zhvillimit Ekonomik Taksave Mjedisit dhe Turizmit e cila bën llogaritjen dhe vjeljen e detyrimeve.

12. TARIFA PËR DHËNIE LICENCE PËR TREGTIM KARBURATI E LËNDË DJEGËSE.

Baza dhe niveli i tarifës

- 1-Niveli i tarifës dhe kushtet për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj, përcaktohen me VKM nr.970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”.i ndryshuar me V.K.M. nr. 344 date 19.04.2017.
2. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 1 000 000 (një milion) lekë.
3. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, është 100 000 (njëqind mijë) lekë.
4. Vlera e pagesës sipas këtij neni është për një periudhe pesë vjeçare.
5. Të ardhurat, që realizohen nga pagesat e tarifave, përdoren në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi, sipas përcaktimeve përkatëse.

Tabela nr. 12

Nr.	Emërtim	Njësia	Tarifa / lekë
1	Lëshim, përsëritje e licensave për stacion të shitjes karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës për automjetet dhe vajrave lubrifikantë.	Licensë	1,000,000

- 2 Lëshim, përsëritje e licensave për njësitë e shitjes së Licensë 100,000
lëndëve djegëse që ushtrojnë veprimtarinë e tyre për
përdorim nga konsumatori fundor.

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e Tarifës për dhënie dhe përsëritjen e licensë për tregtim karburanti, lëndë djegëse e vajra lubrifikant është Drejtoria e Urbanistikës pranë Bashkisë Patos.

13. TARIFË LEJE NON STOP

Tabela nr. 13

Nr.	Emërtimi	Njësia	Miratohet
2.	Bar – restorante (ku zhvillohen ceremoni), diskoteka	lekë/vit	20.000
3.	Bar – Bufë etj	lekë/vit	10,000

Tarifë “leje non stop” është tarifë e cila do të paguhet nga subjekte të cilët do të ushtrojnë veprimtarinë e tyre mbas orës 24.00 dhe që do të pajisen me lejen përkatëse për të zhvilluar aktivitetin e tyre mbas këtij orari.

Leja non stop do tu jepet atyre subjekteve të cilët më parë e kanë kërkuar këtë leje nga Bashkia Patos.

Struktura e ngarkuar për lëshimin e autorizimit të pagesës për tarifën leje non stop do të jetë Drejtoria e Urbanistikës.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e tarifave për leje non stop do të jetë Drejtoria e të Ardhurave Vendore.

14. Tarifat për shërbime nga Drejtoria e Urbanistikës.

Tabela nr. 14

Nr	Emërtimi i tarifave	Njësia matëse	Propozohet
1	Tarifë vendore për urbanistikën (vetëdeklarim) - Personat fizik - Personat juridik Taksë e ndikimit në infrastrukturë për kryerje punimesh të cilat pajisen me deklaratat paraprake: - Personat fizik - Personat juridik - Vetëm për sera të çmontueshme pa themele të vazhduara në shërbim të aktiviteteve bujqësore.	lekë lekë lekë	 3,000 5,000 1% e vlerës së investimit 10,000
2	Tarifë për plan vendosje	lekë	2,000
3	Tarifë plan rievimi	lekë	3,000
4	Tarifë njoftim fillim punimesh, individ	lekë	5,000

5	Tarifë njoftim fillim punimesh, biznes	lekë	10,000
6	Tarifë vendore për vërtetime	lekë	100
7	Tarifë për aplikim për vërtetim mjedisi	lekë	2,000
8	Tarifë për certifikat përdorimi	lekë	5,000
9	Tarifë vendore për leje shqyrtimi ose nxjerrje dosje	lekë	5,000
10	Tarife vendore për kontrollin e zhvillimit të teritorit	lekë	1,500
11	Tarifë vendore për piketim objekti	lekë	1,500
12	Tarifë vendore për përcjelljen e dokumentave në ZRPP	lekë	2,000

Struktura e ngarkuar për përlogaritjen dhe lëshimin e autorizimit për pagesën tarifave për shërbimet urbanistike si dhe vjeljen e tyre është Drejtoria e Urbanistikës.

15. TARIFË PËR PËRDORIMIN E UJËMBLEDHËSIT

16. Për aktivitetet peshkimi – 20 000 lekë/vit

17. PËR ADMINISTRIMIN E UJITJES DHE TË KULLIMIT

Në zbatim të Ligjit nr. 24/2017 “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit”, neni nr.15 “Për përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi” neni nr.16 “Burimet e të ardhurave për bashkinë”, të këtij ligji, përbëhen nga:

- a) tarifa vjetore e mirëmbajtjes së infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit;
- b) tarifa e shërbimit të ujitjes;

Miratimi i tarifave Tarifa vjetore e mirëmbajtjes së infrastrukturës dhe tarifa e shërbimit të ujitjes miratohen nga këshilli bashkiak.

a) Tarifa vjetore e mirëmbajtjes së infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit;

1. Bashkia mbledh tarifën vjetore të mirëmbajtjes për çdo sipërfaqe toke, brenda zonës së saj të shërbimit të ujitjes. Afati i pagesës së kësaj tarife është brenda datës 31 janar të çdo viti.
2. Tarifa vjetore e mirëmbajtjes i njoftohet, me shkrim, zotëruesit të tokës dhe përlogaritet duke iu referuar madhësisë së sipërfaqes së saj.
3. Kjo tarifë përfshin shpenzimet e mirëmbajtjes vjetore të sistemit të ujitjes, shpenzimet për përgatitjen e këtij sistemi për stinën e ardhshme të ujitjes dhe koston e pastrimit të kanaleve kulluese.
4. Miratohet tarifa vjetore e mirëmbajtjes së infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit: të jetë 50 lekë/ dylim .

Drejtoria e Bujqësisë nëpërmjet specialistëve të që ka në njësitë administrative do të dorëzojë te specialisti i të ardhurave vendore pranë njërive listën e fermerëve që kanë përfituar këtë lloji shërbimi ku të jetë përcaktuar sipërfaqja e shërbimit të kryer për secilin fermer.

Tarifa aplikohet vetëm për Njësinë Administrative Zharëz.

Struktura që do të meret me faturimin dhe arkëtimin e kësaj tarife do të jetë specialisti i bujqësisë dhe specialisti i të ardhurave vendore në Njësine Administrative Zharëz.

b) Tarifa e shërbimit të ujitjes

1. Bashkia vendos një tarifë shërbimi për çdo shpërndarje të ujit për ujitje, në bazë të kërkesës së çdo fermeri.
2. Tarifa e shërbimit të ujitjes llogaritet sipas sipërfaqes së ujitur dhe numrit të ujitjeve ose vëllimit të ujit të përdorur për çdo ujitje apo kohëzgjatjes së ujitjes dhe çmimit për njësi kohe.
3. Tarifa e shërbimit të ujitjes për njësi përllogaritet duke iu referuar shpenzimeve për shfrytëzimin e sistemit të ujitjes dhe të shpërndarjes së ujit për ujitje, përfshirë çdo shpenzim të bërë për furnizimin e një rezerve të tillë ujore.

Tarifa e shërbimit të ujitjes:

- 1- Ujitje tokave me vetë rrjedhje nga rezervuari Zharrzës 500 lekë/ dylim.
- 2- Ujitje me ngritje mekanike nga rezervuari i Kurjanit 200 lekë/ dylim .
- 3- Ujitje tokave me ngritje mekanike nga vetë fermeri (Uji me ngritje mekanike nga lumi Seman 500 leke /dylim).

Tarifa aplikohet vetëm për Njësine Administrative Zharëz.

Struktura që do të meret me faturimin dhe arkëtimin e kësaj tarife do të jetë specialisti i bujqësisë dhe specialisti i të ardhurave vendore në Njësine Administrative Zharëz.

18. Tarifë shërbimi për privatizim banese

Tarifë shërbimi për privatizim objekti të kthyer në banesë si dhe privatizimin e çdo pasurie tjetër brenda juridiksionit të Bashkisë Patos është 5 000 lekë/dosje. Struktura për vjeljen e kësaj tarife është sektori juridik që ndjek procedurat.

19. Tarifë për linjat ajrore dhe nën tokësore

Bazuar në Ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, Këshilli Bashkiak vendos taksa dhe tarifa në interes të përgjithshëm të banorëve të territorit në juridiksionin e Bashkisë Patos.

Për operatorët ekonomik të cilët operojnë në territorin e Bashkisë Patos në fushën e shërbimeve, për përhapjen e rrjetit televiziv , kabllor, telefonik internet e të tjera të ngjashme me këto propozojmë si më poshtë:

Tabela. nr, 16

Nr.	Emertimi tarifave	Niveli tarifës
1	Tarifë për linjat ajrore	30.000 lekë/vit
2	Tarifë për linjat nëntokësore	30.000 lekë/vit

Struktura përgjegjëse e ngarkuar për mbledhjen e kësaj tarife:

- për identifikimin e linjave ekzistuese dhe atyre të reja është IMT.
- për përllogaritjen e tarifës për linjat ajrore dhe nëntokësore është Drejtoria e Urbanistikës.

- për vjeljen e saj është Drejtoria e të Ardhurave Vendore.

20. Tarifa të propozuara nga Drejtoria e Arsimit.

Tabela nr. 17

Nr.	Emërtimi	Njësia	
1.	Salla e konferencave dhënie në përdorim	lekë/ora	2500
2.	Salla e kinemasë dhënie në përdorim	lekë/ora	5000
3.	Stadiumi "Alush Noga" dhënie në përdorim	Për aktivitet	5000
4.	Aneksi stadiumit dhënie në përdorim	aktivitet	2000
5.	Holli i katit të dytë i godinës së TregArt, dhënie në përdorim	aktivitet	5,000

Nga këto tarifa do të përjashtohen shkollat & kopshtet publike, shoqatat e paraplegjikëve dhe e personave me aftësi të kufizuar dhe partitë politike.

Struktura për vendosjen dhe vjeljen e këtyre tarifave do të jenë Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria e të Ardhurave Vendore.

21. Tarifa për kuotën ushqimore në kopshtet dhe çerdhet

Tarifa për fëmijet që frekuentojnë kopshtet dhe çerdhet është detyrim mujor.

Detyrimi mujor përbëhet nga Tarifa për Ushqimin, e cila llogaritet me nivelin ditor të tarifës dhe ditët e frekuentimit të fëmijës në çerdhe/kopsht gjatë një muaji.

Përfitojnë reduktim të detyrimit mujor në masën 30% kategoritë e mëposhtme:

1.1. Fëmijë me statusin jetim

1.2. Fëmijë të familjeve ku kujdestari ligjor ka statusin e jetimit.

1.3. Fëmijë me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike dhe me sëmundje të rënda, sipas raportit të komisionit mjeko-ligjor.

1.4. Fëmijë ku kujdestari ligjor është me aftësi të kufizuar mendore dhe fizike dhe me sëmundje të rënda, sipas raportit të komisionit mjeko-ligjor.

1.5. Fëmijet e familjeve mono prindërore, ku kujdestari ligjor e ka pagën nën nivelin e pagës minimale të miratuar me aktin nënligjor përkatës.

Strukturat përkatëse (të kopshteve dhe çerdheve) do të meren me përgatitjen e dokumentave për detyrimin dhe mbledhjen e tyre në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik Taksave Mjedisit dhe Turizmit..

22. Tarifat e shërbimeve që kryen struktura e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi ndaj shtetasve dhe personave, juridik e fizik, vendas e të huaj.

Tabela nr.18

Nr	Tarifat e shërbimeve	Njësia	Tarifa
1	Për kundërfirmimin e studimeve urbanistike, të planeve rregulluese, projekteve të shesheve të ndërtimit dhe të objekteve brenda tyre.	Lekë	

Nr	Tarifat e shërbimeve	Njësia	Tarifa
1.1	Për projektet e mbrojtjes nga zjarri, që u bëhen studimeve urbanistike dhe planeve rregulluese.	Lekë	0,5% e vlerës së projektit
1.2	Për banesat, rikonstrukcionet e tyre e shtesë kati në to, si dhe për çdo lloj objekti ndërtimi, me vlerë deri në 1 000 000 lekë.	Lekë	500
1.3	Për banesat, dyqanet, lokalet, serviset, repartet artizanale, magazina mallrash etj., me vlerë investimi nga 1 000 000 deri në 2 000 000 lekë.	Lekë	1 000
1.4	Për hotelet, motelet, rezidencat, komplekse dyqanesh ose supermarkete me vlerë investimi deri në 20 000 000 lekë.	Lekë	5 000
1.5	Për objektet me vlerë investimi deri në 50 000 000 lekë.	Lekë	10 000
1.6	Për objektet me vlerë investimi mbi 50 000 000 lekë.	Lekë	15 000
1.7	Për ndërtime qyteza e fshatra turistike, si dhe për vepra të tjera me vlerë investimi mbi 1 000 000 USD.	Lekë	50 000
2	Për objektet me rrezik të theksuar për rënie zjarri e shpërthimi.	Lekë	
2.1	Për fabrikat, uzinat e qendrat e përpunimit të naftës e gazit të lëngëzuar, fabrikat e polisterolit e për prodhime kimikatesh, si dhe për vepra e objekte me proces teknologjik me rrezik zjarri të kategorive "A" dhe "B" (përcaktuar me rregulloren e projektimit të ndërtesave të çdo lloji).	Lekë	30 000
2.2	Për depo qendrore karburanti, pika të shitjes së karburanteve dhe impianti të depozitimit dhe mbushjes të bombolave me gaz të lëngëzuar.	Lekë	20 000
2.3	Për qendra e magazina të depozitimit të gazit të lëngshëm me shumicë, të karburanteve e lubrifikantëve në fuçi, të kimikateve e lëndëve të tjera me rrezik zjarri.	Lekë	15 000
2.4	Për projekte të shfrytëzimit të burimeve të naftës, puse të shpim-kërkimit për tubacionet magjistrale të transportimit dhe për të gjithë infrastrukturën që lidhet me shfrytëzimin e tyre.	Lekë	20 000
2.5	Për fabrika mielli, përpunimi druri, përpunimi të bimëve medicinale, të prodhimit të veshjeve dhe objekteve të tjera me proces teknologjik me rrezik zjarri të kategorisë "C".	Lekë	15 000
2.6	Për fabrika e ndërmarrje të përpunimit e prodhimit të produkteve ushqimore, të detergjenteve, të prodhimit kozmetik, të pijeve alkoolike.	Lekë	20 000
2.7	Për rikonstrukcionet që kryen në të gjitha këto objekte, të cilat bëhen në bazë të projekteve përkatëse	Lekë	5 000
3	Për kontrollin teknik pas përfundimit të punimeve	Lekë	
3.1	Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, në përfundimin e veprës apo të objektit, kontrollon, harton dhe u jep personave, juridike e fizike, shoqërive, private e shtetërore, aktin teknik përkatës	Lekë	5 000
3.2	Për përdorimin e automjeteve (autobote) që transportojnë karburante, gaze të lëngëzuar, alkool, kimikate me rrezik zjarri, jepet akti teknik për plotësimin e normave teknike të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit.	Lekë	1 000
3.3	Për ripërtëritjen vjetore të aktit teknik	Lekë	1 000
4	Dhënia personave juridik, vendas e të huaj, licencën për prodhimin, mirëmbajtjen dhe tregtimin e teknikës, pajisjeve zjarrfikëse dhe lëndëve për shuarjen e zjarrit	Lekë	25 000
4.1	Ripërtëritja e licencës.	Lekë	10 000

Nr	Tarifat e shërbimeve	Njësia	Tarifa
5	Për kryerjen e aktekspertizës për zjarret e rëna, kur kërkohet nga organet e prokurorisë, të gjykatës ose nga vetë shtetasit, personat, juridik e fizik, vendas e të huaj	Lekë	25 000

Të gjitha tarifat që do të aplikohen nga ky sektor do ti referohen bazës ligjore: ligjin nr.152 datë 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi” dhe vendimit 285, datë 27.06.2002 “Për tarifat e shërbimeve që kryhen Policia e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit ndaj shtetasve dhe personave, juridik e fizik, vendas e të huaj” .

Struktura përgjegjëse për vjeljen e tarifave është sektori i MZSH.

23 .Tarifa për dhënie me qera të objekteve (pasuri) të Bashkisë

Baza ligjore: VKM nr.54 datë 05.02.2014 ”Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore,(i ndryshuar) dhe udhëzimi nr. 6756, datë 03.09.2015 për zbatimin e VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë.

Struktura përgjegjëse për llogaritjen dhe vjeljen e tarifave është sektori juridik në bashkëpunim me Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik Taksave Mjedisit dhe Turizimit..

24. Tarifa për dhënie me qera të tokave bujqësore, pyjore livadhe dhe kullota në pronësi të Bashkisë

Baza ligjore: ligji nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”,të ndryshuar, VKM nr. 391 datë 21.6.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave” i ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr.391, datë 21.06.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, VKM nr. 460 datë 22.05.2013 “Për përcaktimin e kriterëve rregullave dhe procedurave të dhënies me qera të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”

Struktura përgjegjëse për vjeljen e këtyre tarifave është Drejtoria e Bujqësisë.

25. TARIFA TË SHËRBIMIT NË ZYRËN E GJENDJES CIVILE

Tabela nr.19

Për procedurën e veçimit / bashkim familjesh të shtetasve	1 000 lekë
Për mbajtjen e akteve të lidhjes së martesës	1 000 lekë
Për lëshim dokumenti certifikatë për leje lidhje martese në gjuhë të huaj	200 lekë
Lëshim certifikate martese në gjuhë të huaj	200 lekë
Lëshim certifikate	50 lekë
Lëshim certifikate lindje në gjuhë të huaj	200 lekë

Për regjistrimin e shtetasve të huaj, pas dhënies të shtetësisë 2 000 lekë shqiptare

Struktura e ngarkuar për përlllogaritjen dhe vjeljen e këtyre tarifave janë zyrat e gjëndjes civile në Bashkinë Patos.

26. Tarifë Shërbimi për varrezat publike.

Kjo tarifë do të aplikohet për agjencitë funerale që do të zhvillojnë aktivitet varrimi në territorin e bashkisë Patos. Kjo tarifë ju referohet punimeve që kryhen nga agjencitë e varrimit në varrezat publike.

Tarifa do të paguhet nga subjekti i cili do të kryejë punime në varrezat publike. Kjo tarifë propozohet në masën 5000 lekë.

Struktura përgjegjëse për vjeljet e Tarifës është:

- Agjencia e Shërbimeve Publike Patos.

27. Tarifa për Shërbimin e Varrimit në Bashkinë Patos.

Tarifa për Shërbimin e Varrimit është e përbërë nga Tarifa për Shërbimin e Varrimit dhe Tarifa për Shërbime të tjera.

Tarifa për Shërbimin e Varrimit.

Tabela. nr. 20

Nr.	Emërtimi	Njësia	Vlera në lekë
1.	Hapje grope varri	m ³	2,000
2.	Vendosje pllaka brenda varrit	set	9,000
3.	Mbulim varri	copë	1,000
4.	Vendosje tabele e emrit	copë	1,500
5.	Vendosje bordure betoni	set	4,000
6.	Mirëmbajtje rutinë	copë	1,500
	shuma		19,000

Tarifa për Shërbime të tjera.

Tabela. nr. 21

Nr.	Emërtimi	Vlera në lekë
1.	Leje për bërje qivuri	1,000
2.	Leje për zhvarim	10,000
3.	Leje varrim+zhvarim	15,000

4.	Mbajtja e një vendi rezervë	22,000
----	-----------------------------	--------

Strukturat e ngarkuara për ndjekjen e gjithë procesit deri në arkëtimin e detyrimeve janë Agjencia e Shërbimeve Publike në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanistikës.

27. Tarifa të tjera për Shërbime Administrative

Tabela nr.22

Nr.	EMËRTIMI	Njësia	në lekë
1.	Spektori Protokoll- arshivës		
	Vërtetim indetiteti	copë	falas
	Vërtetim banor i lagjes	copë	50
	Vërtetim për takim në burg	copë	falas
	Për një dokument të nxjerre nga arkivi,në formën e vërtetimit	copë	500
	Dosje të nxjerra nga arkiva të fotokopjuara dhe të njësuara me orgjinalin	dosje	5.000
	Vërtetim për përbërjen familjare	copë	falas
	Vërtetim punonjësi bashkisë	copë	falas
2.	Drejtoria e Financës		
	Vërtetim me nxjerrje të dhënash për pagën (pension)	copë	100
	Vërtetim i thjesht	copë	falas
	Tarifa e shërbimit për fëmijët kopësht, çerdhe	Për femijë	falas
3.	Drejtoria e të Ardhurave Vendore		
	Vërtetim që ushtron aktivitet privat	copë	falas
	Vërtetim që nuk ushtron aktivitet privat	copë	falas
	Vërtetim që ka paguar taksat dhe tarifat vendore	copë	falas
	Vërtetim që ka paguar taksën e tokës bujqësore	copë	falas
4.	Drejtoria e Integritimit Evropian Koordinimit Informimit		
	Deri në 10 fletë formati A4 informacion	fletë	falas
	Mbi 10 fletë formati A4 informacion	fletë	5 lekë/fleta
	Informacion i dhënë me CD	CD	100 lekë/CD
5.	Drejtoria e Ndhmës Ekonomike		
	Aplikim online	Për aplikim	50
	Vërtetim studenti për jashtë shtetit	copë	falas
	Vërtetim që nuk merr ndihmë ekonomike	copë	falas
	Vërtetim që merr ndihmë ekonomike	copë	falas
	Vërtetim për transferim dosje.	copë	100
	Vërtetim paaftësie	copë	falas
	Deklarata mujore e ndihmës ekonomike	copë	falas
6.	Drejtoria e Kadastrës		
	Tërheqje Akt-marrje tapis A.M.T para vitit 2008	copë	1000
	Vërtetim që ka tokë bujqësore	copë	100
	Vërtetim që nuk ka tokë bujqësore	copë	falas
	Vërtetim që zhvillon aktivitet bujqësor	copë	100

	Proces-verbal për mbjelljet me drufrutor	copë	100
--	--	------	-----

Struktura e ngarkuar për lëshimin e vërtetimit dhe mbledhjen për tarifat janë Drejtoritë përkatëse pranë Bashkisë Patos dhe Njësitë Administrative Zharrëz dhe Ruzhdie.

GRUPI PËR MENAXHIM STRATEGJIK